

**HOMAZH PËR ARBËRESHËT TANË
TË ITALISË NË SHËN MITËR
KORONA DHE NË RAJONIN MOLISE
2013 – 2026**



MAL BERISHA





Munxhufuni, 4 gusht 2013



Shën Mitër Korona, 25 prill 2026

**HOMAZH PËR ARBËRESHËT TANË TË ITALISË NË SHËN MITËR KORONA DHE
NË RAJONIN MOLISE**

**2013 - 2026
MAL BERISHA**





San Demetro Corone

25 Prill 2026

Përgatitur nga Mal Berisha

Përkthyer në italisht nga: Sonilda & Jonida Hoti

PJESA E PARË



VIZITA NË SHËN MITËR CORONE, ME RASTIN E KONVENTËS ARBËRESHE, 25 PRILL 2026, DHE SHKRIME RRETH ASAJ VIZITE

Më 25 prill 2026, tek arbëreshët tanë, në San Demetrio Corone, në Kalabri, pikërisht aty ku shënohet lindja e Rilindjes sonë Kombëtare, në Maqi, me poemën e themeluesit të saj, Jeronim De Rada, Milosao, 1835, u zhvillua ajo që u quajt Konventa Kombëtare e Arbëreshëve – San Demetrio Corone.

Pikërisht aty u inaugurua një shtëpi e madhe kulture. Me këtë rast kanë shkruar dhe vazhdojnë të shkruajnë shumë pjesëmarrës, ndër të cilët pata nderin të jem edhe unë. Por unë do të publikoj një cikël të dhënash historike rreth atij vendi.

Po e filloj me kuptimin e mbishkrimeve që gjenden në fasadën e oborrit të shtëpisë së Jeronim De Radës.

Ja transkripti në origjinal dhe në shqip:

Pllaka sipër është e shkruar në italisht.



AL POETA GIROLAMO DE RADA SOMMO VATE ITALO ALBANESE NEL
150 ANNIVERSARIO DI NASCITA IL POPOLO DI MACCHIA AL SUO PIÙ GRANDE
CITTADINO POETIT GIROLAMO DE RADA

Pllaka e sipërme e përkthyer në shqip:

POETIT TË MADH ITALO-SHQIPTAR, NË 150-VJETORIN E LINDJES, NGA
POPULLI I MAQIT, KUSHTUAR QYTETARIT TË TIJ MË TË MADH

MBISHKRIMI NË GURIN E MULLIRIT TË VENDOSUR PËRPARA SHTËPISË

RADA VANVET - 1869

Një gur i thjeshtë, por me një histori kuptimplotë arbëreshe.

“RADA” - është mbiemri i lidhur me traditën dhe me figurën e themeluesit të Rilindjes
Kombëtare shqiptare, Jeronim De Rada.

“VANVET” - duhet të jetë një shenjë dalluese brenda fisit, një emër i brendshëm që
ruante degën familjare.

“1869” – koha kur kjo dëshmi u gdhend në gur.

Ky mbishkrim nuk është thjesht një emër.
Është identitet. Është kujtesë.

Në foto, pikërisht në atë vend, tek ai gur mulliri, me mikun tim, Avni Ponari, ku ndodhen të dy mbishkrimet.

Lavdi veprës së Jeronim De Radës dhe arbëreshëve, që e rilindën kombin pas 300 vjetësh errësire obskurantiste osmane!

Gjaku i “shprishur” na bën përherë krenar!



POSTIMI I DYTË PËR JERONIM DE RADËN NË MACCHIA ALBANESE (MAQI)

Në këtë mur (ne foto) është i vendosur një gur – stol. Aty poeti i madh, Jeronim De Rada, pasditeve, ulej dhe u recitonte kalimtarëve të fshatit të tij, Maqi, vargjet që kishte shkruar në poemën “Këngët e Milosaos”.



Sipër atij “stoli të gurtë” është vendosur pllaka që shihni në foto, ku shkruhet:

GURI I DON XHIROLLËMIT

KËTU VINTE E PREHEJ DHE RRITE ME GJINDJEN E KATUNDIT

- ATO PAK HERË QË NUK ISHTE NË ARBËR -

O HIPTË MBI SHPINËN E GOMARIT,

KUR NË MOSHË TË THYER SHKONTE NË SHËN MITËR

PËR TË MËSUAR GJUHËN TONË.

DON XHIROLLËMI I RADËS,

FLAMURI I ARBËRIT TONË.

(Disegno di Eduardo S. Scarfone Litografia elaborata: Emanuele Amodio)

Italisht:

LA PIETRA DI DON GIROLAMO

QUI VENIVA A RIPOSARE E SI INTRATTENEVA CON LA GENTE DEL VILLAGGIO

- QUELLE POCHE VOLTE CHE SENZA PREOCCUPAZIONI POTEVA

PERMETTERSELO

- O SALIVA SUL DORSO DELL'ASINELLO

QUANDO AVANTI NEGLI ANNI SI RECAVA A SAN DEMETRIO A INSEGNARE LA
NOSTRA LINGUA.

DON GIROLAMO DE RADA,

Stema e Bashkise

FLAMURI I ARBËRISË SONË.

MAQ - MAKIA ARBËRESHE, 28.3.2023

BASHKIA E SHËN MITRIT - ADMINISTRATA KOMUNALE E SAN DEMETRIO
CORONE

KRYETARI - ERNESTO MADEO

Italisht

BANDIERA DELLA NOSTRA ARBËRIA. MAQ - MAKIA ARBËRESHE, 28-3-2023

BASHKIA E SHËN MITRIT - ADMINISTRATA KOMUNALE E SAN DEMETRIO
CORONE KRYETARI - ERNESTO MADEO

Nderim përjetë për këtë arbëresh të famshëm dhe për këtë fshat që e ruajti kujtimin e tij
të përjetshëm.

Mal Berisha, 25 Prill.2026





Gjatë ceremonisë së Konventës Arbëreshe në Shën Mitër patëm rastin të takonim kryebashkiaken arbëreshe të Bashkisë së San Martinos, Iliri Licursi (vini re emrin – ILIRI), si dhe zonjushën arbëreshe Alessia Pennino, studente në Universitetin e Kalabrisë.

Ajo ishte veshur me një kostum arbëresh, të punuar shumë imët me mjeshtëri dhe të ruajtur si mos më mirë. Kostumi ishte gati dy shekuj i vjetër. Kryebashkiakja demonstroi një ndjenjë të lartë identiteti arbëresh dhe nderim për uniformën e autoritetit të vendit të saj të lindjes. Ja si e përshkruajnë ato kostumin e Alessias: “Në zonën e San Demetrio Corone, në provincën e Cosenzës, kostumi arbëresh është ndër më të pasurit dhe më të ruajturit në këtë traditë. Kjo zonë ka qenë qendër e rëndësishme kulturore arbëreshe, ndaj edhe veshja ka elemente shumë të rafinuara. Ky kostum i grave arbëreshe në San Demetrio Corones, i endur dhe i qëndisur aty rreth vitit 1840, është ndër më elegantët dhe përdorej sidomos për festa dhe martesë.”



Këmisha e bardhë, e bërë prej liri shumë cilësor, është e zbukuruar me qëndisje të imëta në mëngë dhe në jakë. Motivet shpesh janë simbolike dhe lidhen me jetën, pjellorinë dhe mjedisin. Pjesa fundore e fustanit të gjatë, e bërë prej mëndafshi ose lesi të tjerrur shumë hollë, shfaqet me ngjyra të errëta, si vishnje, blu e thellë ose e zezë. Ajo ka shumë pala dhe krijon valëzim e elegancë.

Jeleku, ose xhoka, është një nga pjesët më të veçanta. Ai është i qëndisur me fije ari, të ashtuquajtura “ricamo in oro”, me modele shumë të detajuara, nganjëherë me ndikime bizantine. Brezi është i gjerë, zakonisht i kuq ose i artë, dhe nxjerr në pah belin e hollë të gruas, duke treguar gjithashtu pasurinë dhe statusin shoqëror.

Përparësja është e zbukuruar me qëndisje të pasura dhe shpesh krijon kontrast me fundin. Shamia e mëndafshhtë lidhet në mënyrë karakteristike mbi kokë ose mbi supë.

Stolitë janë gjithashtu pjesë thelbësore e kësaj veshjeje. Në këtë zonë, tradita ka qenë familjare dhe fisnore.

Gratë arbëreshe kanë qenë mjeshtret kryesore të qëndisjes me dorë, ndërsa rrobaqepësit lokalë realizonin strukturën e veshjes.

Mjeshtrit e arit në zonën e Cosenzës përgatisnin stolitë dhe elementet e qëndisjes së pasur me ar, më të theksuara se në disa fshatra të tjera. Çdo element i kësaj veshjeje mbart një mesazh. Ajo nuk është thjesht një mjet zbukurues estetik, por edhe një shfaqje e identitetit, një lidhje e fortë me rrënjët shqiptare dhe me besimin e krishterë ortodoks të bashkësisë arbëreshe, dëshmi e prejardhjes dhe e rrënjëve arbërore të komunitetit.

Kostumet arbëreshe janë trajtuar edhe nga revista amerikane National Geographic Magazine në shkrimet e saj për arbëreshët. Alessia dhe Ilirca vazhdojnë traditën fantastike të arbëreshëve.





Fotografi autokrome lumiere nga Luig Perellano (1927)
Gra krenare për kostumet e tyre shumëngjyrëshe në Siçili



POSTIMI I KATËRT NGA ARBËRESHËT E KALABRISË:

Më 25 prill 2026, në ditën e Konventës Arbëreshe, organizuar në Shën Mitër Corone tek arbëreshët, pati disa surpriza të këndshme.

Ndër to dua të veçoj mrekullinë që solli Orkestra e Harqeve SIGAL, e drejtuar nga maestro Ermir Dizdari.

Bashkë me të kishte ardhur edhe sponsori i tyre dhe kujdestari i përhershëm, Presidenti i kompanisë më të madhe të sigurimeve shqiptare, z. Avni Ponari.

<https://youtu.be/19t6Knmvadc>

Ndërkohë, dy motra hotjane-tropojane, Sonilda dhe Jonida Hoti, kishin udhëtuar nga Padova në veri të Italisë drejt jugut dhe kishin sjellë me vete poezinë që ia kishin kushtuar asaj dite.

SONILDA HOTI, JONIDA HOTI

Poezi kushtuar datës 25 prill 2026, me rastin e vizitës në San Demetrio Corone – Itali

JU ARBËRESHËT JENI GJAKU JONË I SHPRISHUR

Ato e kishin shkruar poezinë në italisht dhe Sonilda e recitoi përpara audiencës:

Tra colline antiche e voci di vento,
vive un popolo che non ha dimenticato.
Radici profonde, intrecciate nel tempo,
custodite con cuore fiero e ostinato.

Arbëresh, luce lontana eppure vicina,
eco d'Albania che non si è mai spenta,
lingua che danza come dolce melodia,
memoria viva, mai arresa, mai lenta.

Avete portato oltre il mare il coraggio,
non solo passi, ma storia e identità,
e in ogni gesto, in ogni vostro viaggio,
vive una patria che non morirà.

Noi vi guardiamo con rispetto e amore,
specchio limpido di ciò che siamo stati,
forti custodi di un antico valore,
inermi al tempo, mai dimenticati.

Siete orgoglio, siete verità,
la parte più pura della nostra nazione,
Arbëresh, anima che non cadrà,
siete Albania... nel cuore, in ogni stagione.

=====

Shqip:

Mes kodrave të lashta dhe zërave të erës,
Jeton një popull që nuk ka harruar.
Rrënjë të thella, të ndërthurura në kohë,

të ruajtura me zemër krenare dhe këmbëngulëse.

Arbëreshë, dritë e largët e megjithatë e afërt,
jehonë e Shqipërisë që kurrë nuk është shuar,
gjuhë që vallëzon si një melodi e ëmbël,
kujtesë e gjallë, kurrë e dorëzuar, kurrë e venitur.

Keni çuar përtej detit guximin,
jo vetëm hapa, por histori dhe identitet,
dhe në çdo gjest, në çdo udhëtim tuajin,
jeton një atdhe që nuk do të vdesë.

Ne ju shohim me respekt dhe dashuri,
pasqyrë e kthjellët e asaj që kemi qenë,
ruajtës të fortë të një vlere të lashtë,
të papërkulur ndaj kohës, kurrë të harruar.

Ju jeni krenaria, ju jeni e vërteta,
pjesa më e pastër e kombit tonë,
Arbëreshë, shpirt që nuk bie kurrë,
ju jeni Shqipëria në zemër, në çdo stinë.

Shën Mitër Corona 25 Prill 2026.

Avni Ponari





PROTESTË QYTETARE INDIVIDUALE NDAJ PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Z. BAJRAM BEGAJ.

Postimi i Pestë nga San Demetrio Corone Arbëreshe – Kalabri

Hyrje:

Në ditën e Konventës së Arbëreshëve në San Demetrio Corona, më 25 prill 2025, nuk mund të anashkalohej vizita (për herë të tretë) në vendin më domethënës dhe më kuptimplotë për çdo vizitor shqiptar: Shtëpia dhe busti në fshatin Maqi, aty ku lindi dhe u nda nga jeta themeluesi i Rilindjes sonë Kombëtare, Jeronim De Rada.

NJË SHKELJE FLAGRANTE E BËRË NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS, BAJRAM BEGAJ

Kur vizitori sheh sot bustin e Jeronim De Rada në Maqi arbëreshe, vëren menjëherë një shkelje flagrante të së drejtës së autorit, të bërë nga Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, ndaj veprës së artit: busti i Jeronim De Radës, vepër e Odhise Paskali.

Për habinë e vizitorit dhe, për mendimin tim, pa asnjë kuptim, në anën jugore të piedestalit të bustit të Jeronim De Rada ishte vendosur një pllakë mermeri më e madhe se vetë pllaka ballore ku shënohet emërtimi i monumentit.

Ndonëse pllaka është vendosur me mbishkrim në dy gjuhë dhe e miratuar nga kryetari i bashkisë së fshatit, ajo çfarë ka ndodhur aty është e paprecedencë.

Aty shkruhet:

“Administrata bashkiake e San Demetrio Corone dhe Kryetari Ernesto Madeo falenderojnë Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesinë e Tij Gjeneral Bajram Begaj, për zgjedhjen e qytetit të poetit Girolamo De Rada si vendqëndrim për vizitën e tij të parë në Arbëri.”

San Demetrio Corone, 22 Ottobre 2023

Se çfarë rëndësie ka kjo vizitë, e cila shënohet në njërin nga monumentet më historike dhe ndër veprat më të bukura të artit tonë skulpturor, unë e kam shumë të vështirë ta kuptoj!?

Mendoj se kryetari i bashkisë në San Demetrio Corone mund të jetë vënë në një pozitë të vështirë për t'u thënë "Jo" atyre këshilltarëve të presidentit të radhës së Republikës së Shqipërisë. Por, qoftë ai vetë, qofshin këshilltarët e presidentit, apo vetë presidenti, në fakt kanë kryer një veprim që asnjë udhëheqës i civilizuar i botës, sado narcist të jetë, nuk guxon ta bëjë.

Ajo që bëhet në raste të tilla është vendosja e një kurore me lule dhe shënimi në një bllok vizitorësh i vizitës aty.

Le të imagjinojmë për një moment sikur Ramiz Alia, Sali Berisha, Rexhep Meidani, Alfred Moisiu, Bamir Topi, Bujar Nishani, Ilir Meta dhe tani Bajram Begaj nga Shqipëria, si edhe Ibrahim Rugova, Fatmir Sejdiu, Jakup Krasniqi, Hashim Thaçi, Atifete Jahjaga, Behxhet Pacolli, Vjosa Osmani dhe tani Albulena Haxhiu nga Kosova, të shkonin dhe të vendosnin pllaka mermeri në piedestalet e Jeronim De Rada, të Skënderbeut në Londër e Gjenevë, apo të Naim Frashërit në Bukuresht. Çfarë do të pësonin ata të shkretë?

Prandaj protestoj dhe e shoh krejt pa vend këtë veprim, i cili cenon dhe nuk ka asnjë ngjashmëri midis politikanëve tranzitorë, kalimtarë, të përkohshëm dhe veprës së pavdekshme të figurave të tilla si Jeronim De Rada.

PAK FJALË PËR RILINDASIN TONË TË PARË DHE TË VËRTETË:

Jeronim De Rada (1814–1903) ishte një nga figurat më të rëndësishme të Rilindjes Kombëtare shqiptare. I lindur në San Demetrio Corone, në mesin e komunitetit arbëresh, ai ia kushtoi jetën ruajtjes dhe zhvillimit të gjuhës, kulturës dhe identitetit kombëtar shqiptar.

Ai njihet veçanërisht për veprën poetike Këngët e Milosaos (1836), një gur themeli i letërsisë moderne shqiptare. Përmes krijimtarisë letrare, publicistikës dhe veprimtarisë së tij politike, ai luajti një rol të rëndësishëm në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare.

De Rada studioi dhe më pas dha mësim në Kolegji i Shën Adrianit, ku kaloi pjesën më të madhe të jetës. Ai ndërroi jetë më 1903. Kujtimi i tij nderohet në zonën arbëreshe të Macchia Maqi Albanese, ku busti i tij qëndron si simbol i lidhjeve të qëndrueshme kulturore dhe historike midis arbëreshëve dhe kombit shqiptar.

HISTORIA E BUSTIT TË DE RADËS, VEPËR E ODHISE PASKALIT.

Sipas historianit tonë të njohur të arteve të bukura, akademikut Ferid Hudhri, busti i Jeronim De Radës është skalitur dhe derdhur në bronz nga skulptori i shquar Odhise Paskali, në vitin 1940 dhe fillimisht u vendos pranë Pallatit Mbretëror (më vonë i njohur si Pallati i Brigadave, sot Pallati Presidencial).

Në vitin 1962, një kopje e veprës u vendos në Kalabri, në mjedisin arbëresh të Maqit, San Demetrio Corone, ku qëndron edhe sot si një simbol i lidhjeve të forta kulturore dhe historike midis arbëreshëve të Italisë dhe kombit shqiptar.

Në vizitat që i kisha bërë më parë vendit ku ka lindur dhe ka ndërruar jetë Jeronim De Rada, dhe natyrisht në fotografitë e bëra pranë bustit, nuk kishte asgjë tjetër përveç bustit me atë portret aq shprehës të mjerimit, që vetëm Odhise Paskali mund ta realizonte në atë mënyrë.

Vdekja e tij, pasi humbi tre djemtë dhe pothuajse gjithë të afërmit, në një varfëri të plotë ekonomike, flet më shumë se çdo përshkrim i jetës së tij.

Në faqen ballore të piedestalit ndodhet një pllakë ku shkruhet:

Girolamo De Rada (1814–1903)

Milosao

I

“Lis jeta Kishë ndërruar

uj të zi ndë dejt

kalthëruar të dit’ e re:

por llumbardh e Anakreontit

rronej Temp o moçëme...”

Busti nuk ka të gdhendur asnjë informacion tjetër, as për autorin dhe as për kohën kur është vendosur aty. Mesa duket, ata që e kanë vendosur nuk kanë dashur ta përziejnë emrin dhe veprën e tij me asgjë të përkohshme, aq më pak me figura tranzitore, pa gjurmë ose me pak gjurmë në histori.


Mal Berisha, San Demetrio Corona, 25 Prill 2026



Administrata bashkiake
e San Demetrio Corone
dhe Kryetari Ernesto Madeo
falenderojnë Presidentin
e Republikës së Shqipërisë,
Shkëlqesinë e Tij
Gjeneral Bajram Begaj,
për zgjedhjen e qytetit të poetit
Girolamo De Rada
si vendqëndrim për vizitën
e tij të parë në Arbëri.

San Demetrio Corone 22 Ottobre 2023





PJESA E DYTË

ME ARBËRESHËT NË MOLISE DHE NË KALABRI

Dëshira për t'i parë, njohur nga afër, biseduar, shkëmbyer mendime me bashkëatdhetarët tanë jashtë vendit, qofshin këta të afërt apo të largët, të larguar heret apo vonë nga atdheu, besoj se është ndjenjë e fortë e çdo shqiptari. Por kur puna vjen tek arbëreshët, atë pjesë aq të rëndësishme të kombit tonë, ndjenja bëhet edhe më e fortë. Është ndjenjë kureshtje, respekti, malli. Është dashuri dhe pse jo edhe detyrim ndaj tyre, si njerëz të gjakut tonë që na e ruajtën traditën ndër shekuj ndonëse në vend të huaj. Ishin këto arësytet e shumë udhëtimeve në viset ku shqiptarët kanë lënë gjurmët e tyre e vëçanërisht tek arbëreshët e Italisë. Si është formësuar kjo dëshirë?

47 VJET MË PARË NË GJIMNAZIN "ISMAIL QEMALI" NË LAÇ

47 vjet më parë, në një ditë shtatori të vitit 1969 hyri në klasën tonë mësuesi i letërsisë z. Asllan Bami. Ai sapo kishte kryer studimet për gjuhë – letërsi. Mësues Asllani sillte me vete jo vetëm një entuziazëm të pashoq, por edhe një metodë krejt origjinale të mësimdhënies. Pasioni i këtij mësuesi ishte i lidhur me letërsinë shqipe dhe vëçanërisht me De Radën. Prej tij mësuam për veprën e De Radës, Fshatin Maki ku kishte lindur, kolegjin e zëshëm të Shën Adrianit në Shën Mitër Koronë, Milosaon, Fjamurin e Arbërit, Këngët e Serafina Topisë, Skënderbeun e Pafanë... Mësuam për jetën e tij të varfër dhe fatkeqësitë që i kishin ndodhur. Mësues Asllani jo vetëm na spjegonte jetën e De Radës, por ngjallte edhe një dashuri të pafund për të. Madje ai të mëkonte edhe dëshirën që një ditë të mund ta vizitoje vendin ku De Rada kishte lindur, rritur, shkruar, ndërruar jetë... Natyrisht atë kohë kjo do të ishte një ëndërr shumë, shumë e guximshme. Por a jetojmë në botën ku ëndërrat kthehen në realitet? Prej kohës kur rrugët u hapën, kontaktet me arbëreshët kanë patur një kuptim të caktuar madje shumë të madh.

ME ARBËRESHIN MIKELANXHELO LA LUNA NË RHODE ISLAND

Aty nga viti 2003, kur im bir Kreshniku studjonte në Universitetin Rhode Island në SHBA, më tregoi se merrte mësim të gjuhës italiane nga një arbëresh i quajtur Mikelanxhelo La Luna. Ky arbëresh fliste një shqipë të qartë dhe ishte nga Shën Mitër Korona, bash nga fshati arbëresh ku kishte dhënë mësim Jeronim De Rada, në Kolegjin e Shën Adrianit. Në atë kohë u takuam me profesor La Lunën dhe kaluam një darkë bashkë me tërë familjen time në qytetin Kingstoun në Rhode Island, ShBA. Folëm gjatë për *horën* arbëreshe, u kënaqëm dhe i premtuam njeri-tjetrit se nuk do harrohem. Dhe kështu ndodhi. Herë pas here shkëmbeu mesazhe deri sa në këtë verë e lamë të shiheshim në Shën Mitër Koronën e De Radës dhe të tijën. Dhe ja tek u takuam në mesditën e 29 korrikut 2016, mu në qendër të fshatit ku jetonte vetë La Luna. Vizituam bashkë Kolegjin e Shën Adrianit. Por para se të vinte kjo ditë, shumë lidhje të tjera me arbëreshët do ta bënin vizitën aty një domosdoshmëri.

UDHËTIME NË BOTËN SHQIPTARE

Duke patur fatin të udhëtoj nëpër botë kam patur rastin të shoh vend-banime *shqiptare – arnavute* si dhe vende historike si p.sh. në Turqi, varrin i Sami Frashërit në Feritköy në Stamboll apo vendlindjen e Fan Nolit në Ibrik Tepe. Ato mbeten ndër momentet më emocionale.

Po aq emocionale është të takosh *shqiptaro – arvanitasit* në Greqi. Në Damask të Sirisë, në vitin 2010, kam takuar shumë “*arnavutë*” dhe mësova edhe se pesë mijë familje që mbanin të njejtin mbiemër, “*Arnavutë*”, jetonin aty. Të gjithë më origjinë shqiptare. Ishte po ashtu kënaqësi e veçantë të takoje shkrimtarin më të madh siriano – shqiptar – Abdyl Latif Arnavut i cili jipte këtë spjegim mbiemrit të tij dhe të shqiptarëve sirianë: – “*Njerëz që e duan atdheun deri në vdekje, pavarësisht se ku gjënden*”. Po këtë mendim ndante edhe profesori Muhamed Mufak Arnauti, nga Universiteti Al al-Bejt në qytetin e Mafrakut në Jordani. Të tillë ishin shqiptarët në Jordani, në Liban, krenar për Vaso Pashën dhe në Egjypt për Muhamet Aliun. Të soditësh portretin e tij në Kajro dhe në Londër ishte një prej kënaqësive që një shqiptar ndjen kur gjurmon emrat e njerëzve tanë të mëdhenj. Kur takon shqiptarë në vende të ndryshme, në Zvicër, ShBA, Itali, Francë, Britani, Gjermani, njihesh më mirë me vështirësitë dhe historitë e jetës së tyre. Të bashkëpunosh me Vatrën në New York, bje fjala, siç më është dhënë rasti mua, është si të jesh pjesë e historisë. Po ashtu të bashkëpunosh me Shoqërinë Anglo Shqiptare në Londër është vërtetë një kënaqësi dhe privilegj.

Historitë e bashkëatdhetarëve tanë janë shumë herë individuale, por shume herë ato janë edhe kolektive. Largime në grupe apo arratisje nga Shqipëria, dëbime masive nga Kosova, ngulime sporadike, vendosje në dhe të huaj, pa ditur çfarë i pret për tu shoqëruar nga hallet e jetës, gjuha e huaj, përshtatja, fëmijët, shkollimi i tyre, problemet ekonomike... Kështu ata dalë-ngadalë, si pa e kuptuar, rrëshqasin në honin e pakthyeshëm të asimilimit. Por a ndodhi kështu edhe me:

ARBËRESHËT E ITALISË?

Në tëra këto udhëtime jam munduar të rikrijoj në imagjinatën dhe fantazinë time skenat e zbarkimit të shqiptarëve të asaj kohe në vise të ndryshme të botës. Jam ndalur tek zbarkimet në tokat e Jugut të Italisë. Vuajtjet dhe mjerimet në atdhe, luftërat që zgjatën me dekada, vdekja e Skënderbeut dhe thyerja e rezistencës anti – turke, që i detyruan ata të lëshojnë atdheun e tyre. Kështu vjen eksodi, deti, zbarkimi në vendet e panjohura...“I shoh” tek zbresin të zënë nga deti, të lodhur, ndonjë edhe i vdekur gjatë udhëtimit; të brengosur nga dhimbjet për ata që lanë prapa të gjallë e të vdekur, të mbytur nga malli për shtëpitë dhe varret. Por jo vetëm aq. Edhe e ardhmja? Çfarë i priste? Ku do vendoseshin? Dhe ja vjen një ditë kur gjëndemi në mes tyre:



Pamje e bustit të Skënderbeut, i vendosur në sheshin "Skënderbeg" në Munxhufuni.



Pllaka e sheshit "Skënderbeg", ku është vendosur busti, në fshatin Munxhufuni,



Dita e inagurimit të bustit të Skenderbeut në sheshin “SKENDERBEG” ne fshatin arberesh Munxhufuni.

Me iniciativën e Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, z. Mal Berisha dhe në bashkëpunim me Ambasadorin e Shqipërisë në Itali, Prof. Neritan Ceka, dhe Bashkinë vendase, në fshatin arbëresh Munxhufuni (Montecilfone), Rajoni Molize, Itali, me datën 4 gusht 2013 u vendos busti i Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeg, vepër e skulptorit të njohur Kreshnik Xhiku.

Fshati Munxhufuni është një prej 52 fshatrave arbëreshe të Italisë Jugore. Të vendosur aty pas thyerjes së rezistencës së shqiptarëve ndaj turqve, me vdekjen e Skënderbeut, banorët arbëreshë i kanë ruajtur në mënyrë shembullore gjuhën, traditat dhe zakonet shqiptare deri në ditët e sotme.

Nisma për vendosjen e këtij busti erdhi si rezultat i përshtypjes që la vendosja e bustit të Skënderbeut në qytetin e Londrës, ditën e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, më 28 Nëntor 2012.



Në ditën e inaugurimit të bustit: Sh.T. z. Mal Berisha dhe zonja Donika Berisha, Princi Giorgio Maria Castriota Scanderbeg, një nga pasardhësit e familjes së Skënderbeut, Sh.T. Prof. Neritan Ceka me zonjën e tij Angjelina, si dhe arbëreshja Maria Vittoria D'Inzeo.

Me atë rast, në ceremoninë e vendosjes së bustit morën pjesë arbëreshë dhe italianë me banim në Britaninë e Madhe. Kjo nxiti njerën prej atyre pjesëmarrëseve, zonjushen Maria Vittoria D'Inzeo, banore e atij fshati, që të parashtronte në Ambasadën Shqiptare në Londër një kërkesë për ndihmë për vendosjen e një busti të Skënderbeut në fshatin e saj, Munxhufuni. Autoritetet vendore kishin prej kohësh vullnetin për të vendosur një bust, monument apo statujë të heroit në sheshin e fshatit me emrin Skënderbeg, i shkruar në shqip dhe italisht, pa mundur ta realizonin projektin e tyre.



Busti i Skënderbeut, i vendosur më 4 gusht 2013 në fshatin arbëresh Munxhufuni, në rajonin e Molises, Itali.

Kjo bëri që ambasadori të angazhohej deri në realizmin e kësaj kërkese e cila erdhi zyrtarisht nga Bashkia e fshatit. Për këtë kontribuoi autori i veprës, skulptori tashmë i

njohur Kreshnik Xhiku si dhe pronarët e firmës shqiptare “Kastrati”, Shefqet dhe Leonard Kastrati, të cilët e sponsorizuan atë në pjesën më të madhe.



Moment nga dita e inaugurimit të bustit të Skënderbeut mes arbëreshëve të Munxhufunit.

Busti u vendos në prani të një numri të madh pjesmarrësish arbëreshë, në praninë e autoriteteve rajonale dhe lokale, të Ambasadorit të RSh në Itali Sh.T. Prof. Neritan Ceka si dhe Ambasadorit të Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, Sh.T. z Mal Berisha. Gjithashtu, ishin të pranishëm Princi Georgio Maria Castriota Scanderbeg, një nga pasardhësit e familjes së Skënderbeut, dhe konsujt e nderit të Shqipërisë në Molize, Prof. Savino Cannone, në Kalabri, Vincenzo Cannone, dhe në Brescia, Vincenzo Chimisso.

Vendosja e këtij busti shënon një ngjarje shumë të rëndësishme për ruajtjen e identitetit të arbëreshëve jo vetëm në zonën arbëreshe të Molizes por edhe në tërë Italinë.



Midis arbëreshëve

SFILATA "EQUITES SANCTI MILLENNI"

Diplomatët shqiptarë morën pjesë në një sërë veprimtarish kulturore të organizuara në fshatrat e ndryshëm arbëresh të Molizes. Pas vendosjes së bustit, në Munxhufuni u zhvillua një paradë me rreth 500 figurantë me kostume historike të epokës së heroit tonë kombëtar. Sfilata, e shoqëruar nga koreografi me flamuj, tambure, tromba, u ndal në një arenë të hapur verore për tu transformuar në një spektakël mbi jetën e Skënderbeut që nga fëmijëria deri në vdekjen e tij e më pas eksodin e arbëreshëve drejt trojeve italiane.

Spektakli, tashmë në edicionin e tij të XV organizohej nga shoqata kulturore e Munxhufunit, "Equites Sancti Millenni" me pjesëmarrës nga fshatrat Munxhufuni, Sant'Elia a Pianisi, San Martino in Pensilis, Colletorto, Provvidenti, Ururi, Monte Castello, Maschito, Corinaldo, Campomarino.

Drejtuesit e grupeve pjesëmarrëse në këtë aktivitet u përshëndetën me Ambasadorin e Shqipërisë në Romë, Prof. Neritan Ceka, Princin Giorgio Maria Castriota Scanderberg dhe diplomaten e Ambasadës së Shqipërisë në Londër, pjesëmarrëse në këto aktivitete, znj. Xhoana Papakostandini.

Pas historisë së heroit tonë kombëtar, spektakli vazhdoi me tamburet e ritmet mesjetare të fshatit arbëresh Maschito ne krahinen e Basilikatës. Paraqitja e grupit nga Maschito u bë e tëra në gjuhën arbëreshe dhe ngjalli emocione të forta tek publiku.


INAUGURIMI I EKSPozITËS SË PIKTORIT SHQIPTARO-ITALIAN IBRAHIM KODRA NË CAMPOMARINO



Një ndër veprat e piktorit të madh shqiptaro-italian Ibrahim Kodra, pjesë e koleksionit të piktores Liliana Corfiati.



Piktorja arbëreshe Liliana Corfiati, që e ka dekoruar fshatin e saj arbëresh të tërin me piktura murale. Mike e piktroit të madh Ibrahim Kodra



Të gjitha fasadat e ndërtesave të fshatit Campomarino janë të pikturuara me motive nga jeta arbëreshe, nga piktorja arbëreshe Liliana Corfiati.

Me datën 3 gusht 2013, me ftesë të Kryetarit të Bashkisë së Campomarino-s, Gianfranco Cammilleri, diplomatët shqiptarë morën pjesë në përrurimin e ekspozitës së piktorit Ibrahim Kodra. Ekspozita ishte hapur nën kujdesin e piktores arbëreshe dhe mikes së artistit, Liliana Corfiati. Ajo kishte në koleksionin e saj rreth 20 punime origjinale të Kodrës, të dhuruara asaj nga vetë autori. Ato iu bënë të njohura publikut në mjediset e Pallatit historik "Norante" në Campomarino.



“Dashuria për Shqipërinë ishte kudo në veprën e tij” – shprehet Liliana. “Bukuria e një pikturë nuk qëndron në atë çfarë ajo paraqet, por në ndjenjën që ajo mbart dhe përçon”. Ky ishte mesazhi i Kodrës.

Corfiati është autore e dhjetra pikturave murale në Campomarino, Ururi, Portocannone, Montecilfone, të cilat paraqesin momente të jetës arbëreshe në Itali, eksodin e tyre, personazhe historike, biblike dhe mitologjike si dhe afreska dekorative.

DR. LUIGI PLESCIA - KRYETARI I BASHKISË SË URURIT PRET DIPLOMATËT NGA SHQIPËRIA

Në qytezën e Ururi-t, diplomatët shqipëtarë u pritën nga Kryetari i Bashkisë, Luigi Plescia, këshilli bashkiak, komuniteti arbëresh, dhe familje shqiptare që jetojnë në këtë komunitet që prej viteve '90. Në mbyllje të mbrëmjes në sheshin kryesor të qytezës u dha shfaqja teatrale në gjuhën arbëreshe “Tjetri Shekull”, me autor Guido Tartaglione. Aktorët arbëresh sollën mjeshtërisht në skenë dialogje ironike të cilat sillnin figurativisht jetën e përtëjme mes personazhesh të ndryshme dhe një jurije fantazmagorike shenjtorësh që vlerësonin mëkatet e tyre në Ditën e Gjykimit. Shfaqja u ndoq me interes nga qindra arbëresh që duartrokisnin me emocion dialogjet e bukura në gjuhën arbëreshe. Ky ishte edhe një moment tjetër që dëshmonte ruajtjen e gjuhës dhe traditës arbëreshe.

KRYETARI I KOMUNËS, DR. FRANCO PALLOTTA, MIRËPRET AMBASADORËT BERISHA DHE CEKA NGA SHQIPËRIA

Manifestimi përmbyllës i kësaj veprimtarie u zhvillua në qytezën e Montecilfone-s, ku ambasadorët Ceka dhe Berisha u pritën nga Kryetari i Komunës, Franco Pallotta, si dhe komuniteti vendas. Përveç përshëndetjes institucionale dhe falënderimeve, Ambasadori Ceka dhuroi disa libra të kulturës shqiptare për të pasuruar bibliotekën komunale, ndër të cilat Albumin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë. Ndërsa ambasadori Mal Berisha i dhuroi bibliotekës së bashkisë Munxhufuni disa libra të tij ku përshkruhet edhe jeta arbëreshe e parë nga autorë dhe udhëtarë të huaj. Po ashtu, ai i dhuroi Kryetarit të Komunës z Franko Pallota një statujë të vogël në metal, të Nënë Terezës, një tjetër emër i madh botës shqiptare.

PAS TRE VJETËSH, NGA MOLISE NË KALABRI...

Fshatrat arbëreshe *Çifti, Frasinata, Santa Sophia d'Epiro, San Cosmo Albaneze, San Georgio Albaneze* gjënden në Kalabri. Gjatë rrugës për të shkuar tek ato, gjëja e parë që të bie në sy janë tabelat drejtuese të rrugëve të shkruara në dy gjuhë: italisht dhe shqip. Këtu kupton se je në zonat arbëreshe, por edhe në vendin e lirive dhe tolerancës etnike.

NË KATUNDIN ARBËRESH ÇIFTE (CIVITA)

Fshati Çifte është i vendosur në mes të një lugine të rrethuar tërësisht me shkëmbinj. Në fakt të duket sikur aty je në një hon të krijuar për të kujtuar Kështjellën e Krujës dhe atë të Kalasë së Ali Pashë Tepelenës së bashku. Nga ana tjetër sikur je në këmbët e Kështjellës së Rozafës.

Në Çifte, tradita e respektit ndaj Skënderbeut vazhdon. Në hyrje, objekti i parë me të cilin ballafaqohesh është busti i Skënderbeut. Ne mes të fshatit gjenden dy piktura murale të mëdha, Muzeu i Katundit si dhe Kisha. Aty vërehet qartë tradita shqiptare e ndërtimit e kombinuar me atë të Italisë së jugut. Gëzim dhe krenari për vëllezërit e *“Gjakut tonë të Shprishur”* që e ruajtën identitetin në shekuj. Por kohërat kanë bërë që arbëreshët të ballafaqohen me plakje populsië, largim masiv të rinisë, rënie drastike të lindshmërisë ... Pikturat në fshat të kujtojnë dekorin e fshatrave arbëreshe në Rajonin e Molises.

Fshatrat arbëreshe, si edhe ato italiane të Kalabrisë kanë një karakteristikë të përbashkët: Shtëpitë janë shumë afër me njera-tjetrën. Rrugicat kalojnë nëpër korridore që gjarpërojnë pas çdo cepi shtëpie. Duket sikur nga ballkoni i katit të dytë mund t'i zgjasësh kafënë gjitonit. Dyert vijnë njëra pas tjetrës. Mjerisht një numër i madh i atyre dyerve kishin vite që ishin mbyllur.

“Njerëzia kanë ikur në perëndim”. “Dikur” – na thotë një zonjë, – “ne i linim çelsat në derë dhe askush nuk merakosej për këtë. Por tani, tani jo...ka keqbërës që vijnë nga larg dhe na i rrëmbëjnë gjërat nëpër shtëpitë tona”.

Kalojmë mespërmes fshatit. Një rrap shekullor lëshon hije të rëndë dhe një çezmë freskon me ujtë e vet të ftohtë. Më kujton rrapin e Libohovës dhe atë të Shën Vasilit në Sarandë. Aty janë grumbulluar burrat e fshatit dhe kuvendojnë arbërisht. Afrohemi dhe flasim me ta. Kemi vështirësi të kuptohemi por jo se nuk merremi vesh. Pasi na pyesim se nga jemi dhe iu tregojmë që jemi nga Shqipëria njëri nga ata na thotë:

“Ah mirë, mirë, thamë se jeni nga Kosova. Ata nuk na kanë harruar asnjëherë”. Pastaj përshëndetemi me një zonjë që ka dalë në ballkon. Ajo menjëherë na tregon që është arbëreshe dhe fshati është i tëri i populluar me arbëreshë. *“Katundi, – na thotë ajo, – kishte pesë mijë vetë, por tani nuk jemi as tre mijë. Njerëzia po ikin”.* Ecim dhe shohim se në mes të fshatit gjendet kisha. Pranë saj ndodhet edhe muzeu etnografik.

VIZITË NË “MUZEO ETNIKO ARBËRESH” NË ÇIFTE

Në katund të orientojnë tabelat: *“Këstjeli i Krujës”, “Udhëtim Mëmëklisha”, “Grykat e Rrakanjelit”, “Ura e Djallit”, “Muzeo Etniko Arbëresh”.* I kalojmë të gjitha dhe vimë tek muzeu. Hyjmë brenda dhe para nesh shfaqet një muzeum që të bën të ndalësh frymën. Ai është i mbushur me gjërat më përfaqësuese të arbëreshëve: Veshje popullore, qëndisje

me dorë, vegla pune, libra, koleksioni i revistës “*Katundi Ynë*”, botime, fotografi njerëzish të shquar, historira të fshatit. Muzeu funksionon që prej vitit 1970. Cicëroni na tregon dhe për kujdesin e treguar nga diplomatët shqiptar Visar Zhiti dhe Gerarta Zheji Ballo për studimet e fshatit. Dhimitri Emmanueli, botuesi i revistës na citon në arbërisht:

“Kur isha i vogël gjith folëjin arbrisht. Edhe kushërinjët ka Kasana folëjin arbrisht sepse e jëma cje Maria ish Ciftjote. Edhe sot, na miq, çë nëngë jemi aq trima, folëmi, me hir dashje, arbrisht. Edhe kur përpiqemi me miqtë ka Frasinata, ka Ungra, ka, Spixana, ka Shën Mitri, ka Mbuzati, ka Strighar, edhe ka Picilia folmi arbrisht. Po trimat me ata më të voglit folëjin vetëm italisht.”

“BUKË DHE VERË” ARBËRESHE NË SANTA SOFIA D’EPIRO

Ndalemi në fshatin Santa Sofia d’ Epiro. Aty menjëherë dallojmë dy gjëra shqiptare: Flamurin shqiptar përkrah atij italian dhe european që valviten pranë e pranë në fasadën e kishës. Në krah të kishës gjëndet një restorant mbi derën hyrëse të të cilit shkruhet në gjuhën shqipe: *Bukë dhe Verë*.

Ndalemi dhe flasim me arbëreshët e klubit. Ndjejmë mikëpritjen e njerëzve të gjakut tonë. Na ftojnë të pimë diçka të freskët. Njeri më thotë:

“Eja me mua të shohësh Fjamurin tënë mbi kishë”!

Dhe vërtetë ashtu ishte. Aty në një dyqan të thjeshtë gjejmë edhe disqet e këngëve për arbëreshët të inçizuar nga këngëtari shqiptar Lirio Nushi nga Vlora. Në njërën prej tyre thuhej:

“Askush nuk mund të më kthej nga rruga që jam nisur,

Askush nuk më ndalon dot të shkoj ndër arbëreshtë,

Atje më janë vëllezërit e mi të lashtë,

Atje më janë vëllezërit e mi antik,

Bijtë e arbërit me gjak të pashprishtë”.

Pastaj njëri syresh, më jep një letër me një vjershë me dymbëdhjetë strofa të fotokopjuar në dy anët. Ai e konsideron atë si dhuratë të madhe dhe më thotë:

“Unë quhem Angelo, arbërisht Engjëlli. Ky fshat ka patur Angelo Mascin, Merre këtë, e kam shkruar vetë”.

Më pëlqejnë vëçanërisht vargjet e mëposhtme: Janë vargje nga vjersha e quajtur:

“Shënjtjes Vener”

Shënjtja Vener, vashë Hadhjare,

Gjith’o mir, gjith lipisjare;

Na të truhomi me lot
Ndihma neve Ti nga mot.

.....

Ti ndëlona gjithë ftesën,
Zgjona mallin e rritna besën;
E kur të vijnë e sosmja dit,
Dil përpara e na prit.

ME MIKILENAXHELO LA LUNËN NË SHËN MITËR KORONËN E DE RADËS

Në mesditën e 29 korikut 2016, “grupi” ynë ishte musafir i Mikelanxhelo La Lunës në Shën Mitër. Jemi po ata që ishim në Munxhufuni, Anja tani është gjashtë vjeçe, italiani Sergio me Xhoanën, Donika dhe unë. Mikelanxhelo quhej edhe babai edhe njëri nga djemtë e De Radës. La Luna është krenar për origjinën e tij, jo vetëm si arbëresh por edhe si bashkëfshatari i De Radës. Ai na pret me tërë dashamirësinë e vëllait që e pret për shumë kohë një takim të tillë. Pastaj na tregon për turet dhe seminarët që organizon me të huajt, vaçanërisht me studentë amerikanë, të interesuar për arbëreshët. La Luna na tregon për fshatin, historinë e tij, dhe mbi të gjitha historinë e Kolegjit të Shën Adrianit dhe të Shën Mitër Koronës. Por më parë le të vizitojmë fshatin e lindjes së De Radës, në Maki:

NË MAKI - NË FSHATIN E LINDJES SË DE RADËS



Foto pranë bustit të Jeronim De Radës, vepër e skulptorit Odhise Paskali.

Fshati Maki nuk është larg nga Shën Mitri, rreth katër kilometra. Sapo hymë në fshat na shfaqet busti i De Radës, përpara Kishës. E nderojmë atë dhe hymë në rrugën me emrin “Jeronim De Rada”, e cila hapet pasi lemë kishën në të djathtë dhe bustin e poetit në të majtë. Aty shohim një derë harkore që të shpie në një oborr. Është një portik oborri pa derë. Ne shohim fasadën ballore të murit të shtëpisë së De Radës. Në hyrje, në krahun e majtë gjendet një pllakë në të cilën shkruhet në mermer të bardhë në gjuhën italiane:

Në këtë vend në vitin 1814, ka lindur Jeronim De Rada, poeti dhe themeluesi i letërsisë shqipe. Vdiq në vitin 1903.



Hyrja e shtëpisë së rilindasit të madh Jeronim De Rada. Përpara se të nisej për në Kolegjin e Shën Adrianit për të mësuar nxënësit arbëreshë, ai përdorte këtë gur mulliri për t'u ngritur kur i hipte gomarit të tij dhe përshkonte rreth pesë kilometra.

Brenda oborrit të rrethuar nga shtëpitë tjera shfaqet edhe një pllakë tjetër mermeri ku shkruhet:

Poetit të madh shqiptaro italian, në 150-vjetorin e Lindjes, Nga populli i qytetit të tij.

Aty gjëndet edhe guri i De Radës të cilin ai e përdorte për të hypur çdo ditë në gomarin e tij që të shkonte në Shën Mitër Koronë. Ai mbetet një shenjë e varfërisë së tij, thjeshtësisë, përunjësisë, modestisë e sot për ne e madhështisë së tij. Studjuesit e jetës së tij thonë se edhe pak kohë para se të vdiste në Manastir, ai vazhdonte të shkonte dhe të jipte mësim nga Maki në Shën Mitër.

Jemi pikërisht aty ku jetoi njeriu më i rëndësishëm i letrave shqipe të deri asaj kohe. Jeronim De Rada[11]. Tek ecën kalldrëmeve aq të pastra të atyre rrugëve të fshatit, nuk rri dot pa imagjinuar Jeronimin fëmijë tek luante, djalosh tek projektonte të ardhmen, burrë, tek ndërtonte veprën e tij të pavdekshme, plak të urtë meditativ që vuante humbjen e katër djemve të tij dhe mjerimin shpirtëror sa për familjen aq edhe për atdheun. Eh këta poetët! Mendja më shkon edhe tek Lum Lumi dhe tek Ationi! De Rada i mbylli sytë me brengën e madhe për Shqipërinë duke lënë një emër dhe trashëgimi të madhe.

ALTIMARËT, ARBËRESHËT VAZHDUES TË TRADITËS DE RADIANE

Pak më tej ndoshta jo më shumë se pesëdhjetë metra, brinjas rrugës “De Rada” gjëndet një shtëpi e madhe, shumë e vjetër, me mure të ndërtuara me teknika të ndryshme, tullë, dru, gur, hekur. Është shtëpia e Altimarëve, njëri prej të cilëve është sot shumë i njohur në botën arbëreshe, madje edhe në atë shqiptare dhe italiane dhe në botën e studjuesve të albanologjisë. Ai është një studiues i zoti aq sa edhe një mbrojtës i flaktë i pastërtisë së gjuhës shqipe dhe ruajtjes së saj nga ndikimi dhe futja e fjalëve të huaja në të. Është profesor *Francesko Altimari* me të cilin jemi njohur nga afër në kremtimet e 100-vjetorit të

Kongresit të Manastirit në Shkup, Manastir e Tetovë, në nëntor të vitit 2008. Aty, ai bashkë me arbëreshë të tjerë në Kongres e nderuan atë 100-vjetor me studimet dhe kontributin e tyre për gjuhën shqipe. Por le të kthehemi sërish tek De Rada.



HISTORIA JONË DERI NË KOHËN E DE RADËS

Ai njeri që mbart' te brengën shqiptare të shekullit të pesëmbëdhjetë, ishte vetë njeriu që e ringjalli gjuhën shqipe të shkruar pas gati katër shekujsh gjumi letargjik. Pas vdekjes së Skënderbeut, shenja e parë e shqipes ishte Meshari i Gjon Buzukut i botuar në vitin 1555 dhe i zbuluar vetëm në vitin 1740. Pastaj vijnë Lekë Matrënga dhe Doktrina e Krishterë (1592), Veprat e Pjetër Budit (1618-1621), Frang Bardhi dhe fjalori i tij latinisht-shqip (1635), Pjetër Bogdani dhe Cuneus prophetarum (1685)

Po përpara, gjatë dhe pas kësaj periudhe çfarë bëhej me ne shqiptarët? Duket se ora e kombit kishte ndalur. Mijërat e shqiptarëve kishin emigruar drejt jugut të Italisë. Të mbeturit ishin ballafaquar me shtypjen dhe shfarosjen. Një pjesë e kombit mbijetoi. Breza të tërë u shuan. Të rinjtë u morën me forcë si jeniçerë. Kontaktet me botën e qytetëruar u ndërprejnë. Në atdhe, e vetmja mënyrë jetese ishte t'i shërbeje Perandorisë Osmane, ose të zhyteshe në terrin otoman, për të mbijetuar pa ndërgjegje, pa libra abetarje, pa komunikim kombëtar të shkruar.



Arbëreshi Francesco Crispi, dy herë kryeministër i Italisë & Papa Klementi XI Albani – Papa i 243-të i Romës.

Në anën tjetër të detit, në Italinë fqinje ishin vendosur arbëreshët, shqiptarët që nuk e duruan dot dhunën osmane dhe as kishin më forca për t'i rezistuar asaj. Ata morën me vete lavdinë e Skënderbeut për ta mbajtur gjallë deri në ditët e sotme e bashkë me të edhe krenarinë e madhe të të qenurit pjesëtarë të një kombi që kishte bërë rezistencën më të madhe anti - osmane në Ballkan duke mbrojtur edhe Gadishullin Apenin në barrierën që i vunë turqve në anën lindore të Adriatikut dhe Jonit. Ata i dhanë botës së krishterë Papën Clement XI, Alban dhe Italisë Kryeministrin Francesco Crispi, ndërsa atdheut një mori emrash të shquar të cilët do ta bënin të njohur kombin dhe çështjen e tij si *Zef Serembe, Jul Variboba, Gavril Dara i Riu, Zef Skiroi Di Maxho, dhe mbi të gjithë De Radën*. Dhe jo vetëm kaq. Në oborrin e Kolegjit të Shën Mitër Koronës kur je ballë për ballë me të, në krahun e djathtë, qëndron krenar një bust i Xhuzepe Garibaldit. Ai nderohet aty për bashkimin e Italisë por edhe për rolin që arbëreshët kanë luajtur si trimat dhe luftëtarët më të vendosur e më besnikë. Dhe ky rol nuk është i thjeshtë: Ka të bëjë me bashkimin e njërit prej kombeve e shteteve më të fuqishme të botës. Në kthim Garibaldi i dha një fond të madh kolegjit arbëresh që të vazhdonte veprimtarinë si dhe hapi katedrën e gjuhës shqipe aty.



Rruga "Skënderbeg" në Romë.


KOLEGJI I SHËN MITRIT

Në Kolegjin e Shën Mitrit dhanë mësim Profesor Gasper Jakova Mërturi (1903-1904), Profesor Battista Groppa nga Fashineto (1904 - 1906), Profesor Aleksander Xhuvani (1906-1909), Dr. Nikoll Martin Camaj (1911 - 1912), Mehdi Frashëri, (1911 - 1912). Ndërkohë që dy emëra të njohur të politikës shqiptare, Avni Rustemi e Luigj Gurakuqi kanë studjuar aty. Ky i fundit në vitin 1897 shkoi të studjonte në Kolegjin e Shën Mitrit si nxënës i De Radës, i cili sipas Dr. Robert Elsit, pat një ndikim shumë të madh në formimin e tij.



Kolegji arbëresh i Shën Adrianit në Shën Mitri Koronë (Kalabri, Itali).

377 VJET "HESHTJE" DERI TEK MILOSAO E JERONIM DE RADËS




Po të marrim të mirëqenë përdorimin e shkrimit të gjuhës shqipe deri në ditën kur vdiq Skënderbu, atëherë do të shihnim se deri në botimin e "Milosaos" kanë kaluar 377 vjet. 377 vjet "heshtje" është një periudhë e gjatë. Shqiptarët ishin shfaqur ndër luftëra të mëdha dhe kishin bërë histori. Ata lanë emra dhe vepra të mëdha në historinë e Mesdheut. Po vetë sa ndikonte kjo në jetën e shqiptarëve? E vërtetë është: Mehmet Ali Pashaj krijonte Egjiptin. Qyprlyjtë i jipnin 300 vjet jetë Perandorisë Osmane...! Ali Pashë Tepelena priste dhe përcillte në oborrin e tij lordë e misionarë, por njëhej edhe për natyrën

e tij të egër ndaj vetë shqiptarëve! Sikur tu referohemi vetëm dy ngjarjeve të historisë pararendëse të arbëresheve dhe De Radës do të shihnim se shqiptarët bënë histori, por...çfarë bënë për vete?

AGJENTËT E PERANDORISË DHE...

Në librin e Sir Noel Malcolm *“Agjentët e Perandorisë”* mësojmë se në shek XVI shqiptarët u bënë tejet të rëndësishëm jo vetëm në Perandorinë Osmane por edhe në ato të Perëndimit. Kështu për shembull, pinjollë të familjes shqiptare nga Ulqini, Bruni e Bruti u vunë në komandë të ushtrive kundërshtarë në Betejën e Përgjakshme të *Lepantos*. Veç, për fatin e keq të historisë tonë, edhe pse të një gjaku luftonin në llogore të ndryshme. Njëri drejtonte forcat e Lidhjes së Shenjtë dhe tjetri ato të Perandorisë Osmane. Ky i fundit u vra vetëm njëqint metra larg tjetrit, diku në Egje afër ishullit të Qipros. Profesor Malcolm thotë:



Kopertina e librit *Agjente perandorake*, shkruar nga historiani i shquar britanik Sir Noel Malcolm.

“Në librin tim kemi një pjesëtar të familjes që është kryepeshkop shumë i rëndësishëm i Kishës Katolike, ndërkohë që një tjetër punon për Papën si oficer i lartë ushtarak. Ata gjenden në ushtrinë e Mbretit të Spanjës dhe janë kalorësit më të shquar. Në anën tjetër, një kushëri i tyre bëhet një nga pashallarët më të rëndësishëm në Stamboll dhe arrin të bëhet Vezir i Madh. Më në veri, në Moldavi, një tjetër shqiptar luan një rol të jashtëzakonshëm. Është e vështirë të përgjithësosh rolin

e shqiptarëve në atë periudhë, por kur sheh pozicionet e rëndësishme që ata kanë mbajtur në politikë, shoqëri dhe ushtri, vjen në përfundimin se ata gjendeshin kudo.”

Më tej ai shton:

“Unë i jam referuar një raporti të një diplomati austriak, që thoshte”:

“Nëse dikush dëshironte të bënte tregti me Perandorinë Osmane, ishte shumë e rëndësishme që të njihete një shqiptar”.

Këto thënie të professor Malcolmit na bëjnë të ndihemi krenar për zotësitë që tregonin shqiptarët. Por nga ana tjetër nëse e shohim me një sy pak më kërkues ndaj vetvetes, na lind pyetja: Çfarë bënë këta njerëz për vetë Shqipërinë dhe shqiptarët? Le t’i referohemi një figure tjetër, aventureske, shqiptare që kishte shkaktuar një ndër ngjarjet më të mëdha të kohës së vet në Perandorinë Osmane:

...PATRONA HALIL...

Sipas rrëfimit të Lordit anglez *Sanduich* i cituar nga *Sir James Henry Skeene*, Patrona Halil ishte lindur në një familje shqiptare në Hurpisht, një fshat afër Manastirit në vitin 1690 dhe ka vdekur më 25 nëntor 1730, në Stamboll. Ai njihej si *Arnauti Horpeshteli*, por bashkëvendësit e tij shqiptarë e thërrisnin Patrona. Ai udhëhoqi një kryengritje, e cila arriti të rrëzonte Sulltan Ahmetin e III-të dhe të sillte në fuqi Sulltan Mahmutin e I - rë. Pas kësaj aventure ai vetë u ekzekutua në prani të sulltanit që vetë e kishte sjellë në fuqi bashkë me 7000 pasonjësit e tij shqiptarë. Sulltani u zëvendësua, por Patrona e pagoi me jetë të mirën që i bëri bashkë me mijëra shqiptarët e tij.

Kur dëgjon për këto fakte të shtohet admirimi për De Radën, pasi aftësitë gjeniale të tij si shqiptar, ndonëse mund t’i shkrinte në shërbim të një kauze tjetër, i përdori për kombin e vet, gjuhën dhe çështjen tonë kombëtare.

ARBËRESHI DE RADA - VIJA NDARËSE MIDIS ERRËSIRËS OTOMANE DHE DRITËS SHQIPTARE QË PO LIND’TE

Brenda Kolegjit të Shën Mitrit në vetë kishën e saj, La Luna na spiegon me durim për atë çfarë ishte kolegji para De Radës, gjatë De Radës dhe pas tij deri më sot. Kolegji i Shën Mitrit, na thotë ai, është ndërtuar, këtu, rreth truallit të Kishës së Shën Adrianit e ngritur rreth vitit 1000. Kolegji e ka filluar veprimtarinë e tij në vitin 1470 i themeluar nga pararadhësit tanë shqiptarë. Kisha është një shembull i arkitekturës Normano – Bizantine dhe në të gjenden shumë vepra arti, mozaike dhe relike të vjetra antike. Bien në sy kolonat korinthiane të zbukuruar me gdhendjet në krye me formën e gjetheve të bimës mesdhetare *acanthus mollis*.

Në mënyrë të veçantë ai na spiegon për mozaiket origjinale të gjarpërinjëve në dysheme, ndër të cilët dallohet njëri i cili ka tre nyje të përdredhura në trup në formë unazash,

dëshmi e trinitetit. Më pas ai na tregon bustin e De Radës i cili gjëndet brenda oborrit të kolegjit, ballë për ballë me atë të Garibaldit. Dhe vijon me tregimin rreth historisë së De Radës:

KËNGËT E MILOSAOS, KËNGËT E SERAFINA TOPISË, SKËNDERBEU I PAFAN...


De Rada fitoi emër me poemën epiko – lirike “*Këngët e Milosaos*” botuar në vitin 1836. Këtu e ka bazën edhe fillimi i Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe i letërsisë tonë të romantizmit. Më pas ai vazhdon me një vepër tjetër, edhe kjo me subjekt nga Shqipëria, e njohur me emrin “*Këngët e Serafina Topisë*”. Por vepra më e rëndësishme e De Radës mbetet “*Skënderbeu i Pafan*”, të cilën e botoi në vitin 1896. Veprat e tij mendohet se i njihete edhe nga vetë Viktor Hygoi por në veçanti ato njiheshin nga poeti i shquar francez La Martin.

“De Rada u lind në vitin 1814 në Maki të Kalabrisë. Mësimet e para i mori këtu në këtë kolegji ku jemi sot” na tregon La Luna. Më 1834 ai shkoi për të studiuar drejtësi në Napoli, ku mori pjesë gjallërisht në lëvizjen politike dhe kulturore të kohës. Më 1848 nxori të parën gazetë shqiptare “*Shqiptari i Italisë*”. Më 1848 ai u kthye në Maki deri në fillim të viteve 60 të shek. XIX. Në vitin 1861, boton librin “*Principet e Estetikës*” (Principi di estetica), pastaj “*Lashtësia e Kombit Shqiptar*” (“*Antichità della nazione albanese*”). Në vitin 1864 boton “*Rapsodi të një poeme arbëreshe*” (“*Rapsodie d’un poema albanese*”). Këto vepra ndikuan fuqishëm në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve. Ai kishte korrespondencë me veprimtarë tjerë të çështjes kombëtare, ndër të cilët me Dora D’Istrian. Ai përkrahu lëvizjen për bashkimin e Italisë. Ndërkohë përkrahu Lidhjen Shqiptare të Prizrenit në vitin 1878. Revista e tij “*Fjamuri i Arbërit*” botuar nga viti 1883 e ndihmoi jashtëzakonisht shumë çështjen kombëtare shqiptare. Në vitin 1902, pak para vdekjes ai botoi një “*Testament politik*” për çështjen shqiptare. De Rada ka një meritë të veçantë në studimin e gjuhës dhe gramatikës shqipe. Ai ka botuar dy vepra gramatikore ku argumenton lashtësinë e gjuhës shqipe. Po ashtu ai organizoi dy kongrese të gjuhës shqipe njerin në vitin 1895 në Koriliano Kalabro dhe një në vitin 1897 në Lungro. Ai e dha mësimin e gjuhës shqipe këtu në Kolegjin e Shën Adrianit – Shën Mitër Coronës për dhjetra vjetë.

Pas këtij rrëfimi të La Lunës mendja të shkon tek shumë studjues të cilët janë marrë dhe merren me çështjen e arbëreshëve të Italisë. Duke respektuar punën e tyre, në këtë shkrim, e gjej me vend t’i referohem një shkrimtari të famshëm austriako – anglez, i cili konsiderohet si rrëfimtari më i mirë midis udhëtarëve britanikë të kohës. Dhe këtë emër ai e ka fituar me librin e tij të njohur “*Kalabria e Vjetër*” Ai është:

NORMAN DAUGLAS - “SHQIPTARËT DHE KOLEGJI I TYRE” DHE “NJË PROFET SHQIPTAR” NË LIBRIN: “KALABRIA E VJETËR”

Norman Douglas ka studjuar tërë grupet etnike dhe jetën e tyre në Kalabri duke u ndalur tek arbëreshët. Ndër të tjera për arbëreshët ai shkruan:



Sa bukur i përshkruan në këtë libër Norman Douglas arbëreshët në Kalabri!

“Këto fshatra jo-italiane datojnë nga shekujt pas vdekjes së Skënderbeut kur Sulltani (The Grand Signor) e përforcoi pushtetin e tij. Refugjatët arritën grumbuj – grumbuj nga deti. Atyre iu dhanë toka të egra ku do të vendoseshin. Të ardhurit e rinj u morën për bizantinë.

Kolonitë e shqiptarëve u shpërndanë nëpër tërë Italinë e Jugut më së shumti në Pulia, Kalabri dhe Sicili. Disa u vendosën dhe në veri edhe në qendër. Ishte edhe një vendbanim në Lumin Po, por që është reduktuar në 200 banorë; shumica e tyre më vonë janë absorbuar dhe shkrirë brenda elementit italian. Sipas Angelo Masci (1846) ai thotë se janë 59 fshatra të tyre, me 83 mijë banorë – veçanërisht në Siçili; Morelli thotë se numri i përgjithshëm i arbëreshëve për Italinë dhe Siçilinë është tek 103.466. Nëse ky numër është i vërtetë, atëherë kjo shumë tani duhet të kalojë të dyqindmijët. Unë mora vesh se tani gjenden 80 fshatra të populluara prej arbëreshëve me nga 2500 banorë secili, po të llogarisim edhe ata që kanë emigruar në ShBA. Gjuha shqipe tashmë zotëron më shumë se tridhjetë alfabetë të ndryshme, secili me më shumë se tridhjetë germa. Gjithsesi, në këto katërqind vjetë ata nuk e kanë ndarë mendjen se cilin do të mbajnë.”

Më pas Norman Douglas ndalet tek themeluesi i vërtetë i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Jeronim De Rada. Ai pasi përshkruan jetën e tij, vështirësitë, dramën e tmerrshme familjare, faktin që ai nuk kishte udhëtuar kurrë jashtë, madje as në vise të tjera arbëreshe brenda Italisë, thotë:

“Shkrimet e tij të shumëllojshme – dhe padyshim risia e temës së tij qendrore – tërhoqën vëmendjen e gjuhëtarëve dhe filologëve gjermanë të kohës, të tërë të dashuruar pas lirisë, folklorit dhe poezisë. Shkrimtari i njohur italian Cantù, e vlerësoi atë shumë lart. Lamartini, në vitin 1844 i shkruajti atij: “Unë jam i lumtur për vëllazërinë poetike dhe politike që ekziston midis teje dhe meje. Poezia erdhi nga brigjet tuaja dhe duhet të kthehet andej nga erdhi”. Herman Buchholtz zbulon tek ai skena të denja për shkrimet e Shekspir-it dhe pasazhe madhështore të denja për skena eskiliane në tragjedinë e tij Sofonisba. Dijetari i madh Gladstone thuhet se i shkruajti një kartolinë ku e laodëronte për përpjekjet e tij në emër të vendit të vet”.

Ishte ai që krijoi gjuhën letrare të vendit të tij, që hyjnizoi lidhjet midis Shqipërisë dhe Pellazgëve dhe që formuloi ambicinet e saj politike. Deri në atë kohë ajo ishte thjesht një mit”.

Dhe shton:

“De Rada ishte një patriot i flaktë prej të cilit morën trajtë aspiratat e stuhishme të Shqipërisë. Ideali që e drejtoi krejt jetën e tij ishte ringjallja e vendit të tij. Dhe nëse vëmendja e kongreseve ndërkombëtare dhe lingusitikës e folklorit është tërhequr tek ai cep i vogël i botës, nëse në vitin 1902 njëzet e dy gazeta i kushtoheshin çështjes shqiptare, (vetëm në Itali botoheshin tetëmbëdhjetë të tilla dhe një në Londër), e tëra ishte merita e tij. Biografët e tij numërojnë dyzet e tre vepra të dala nga pena e De Radës. Në krye të tëra veprave të tij qëndron “Fjamuri i Arbërit”. Gazetaria, folklori, poezia, historia, gramatika, filologjia, etnologjia, estetika, politika, morali – asnjë prej tyre nuk mungon në penën e tij të talentuar.”

Shënimet e këtij udhëtimi do t’i mbyllja me një falenderim për tërë ata arbëreshë të cilët i shërbyen çështjes tonë kombëtare. Ndaj duke u larguar nga Kalabria më vjen ti shkruaj këto vargje:

Lamtumirë!

*Sa shumë kanë ardhur dhe kanë ikur,
Tek ty Kalabri’ e Vjetër?
Për të parë dhe ndërë gjithçka:
Deri tek kujtimet e mugëta’ hi-mbetur.*

*Të arbëreshëve, anë detit, një kujtim,
I qënies tonë pellazgjike – një vegim,*

*Thirrje e gjakut të pa tretur, i pasosur – kurrë:
Që buron dashuri dhe mall si uji në një gurrë.*

*Një ditë është pak, as një jetë nuk mjafton,
Të shuash mallin shekullor që të pushton,
Mes vëllezërish humbur deteve, gjetur në Kalabri
Që të falin sot kaq ndjenjë, dramë e poezi.*

Mirëupafshim në Sicili,

Mal Berisha, Kalabri, Korrik, 2016.

KUJTIME NGA VEPRIMTARIA NË SHËRBIM TË LIDHJES QYTETARE SHQIPTARO-AMERIKANE, DREJTUAR NGA KONGRESMENI AMERIKAN ME ORIGJINË ARBËRESHE, HON. JOSEPH DIOGUARDI 1995 -2001



ALBANIAN AMERICAN CIVIC LEAGUE

PËR NDER TË PËRVJETORIT TË 81 - të TË LINDJES SË ISH - KONGRESMENIT AMERIKAN ME ORIGJINË SHQIPTARE JOSEPH DIOGUARDI¹

Duke pas qenë një mbështetës i palëkundur i kauzës së tij në dobi të çështjes shqiptare në përgjithësi dhe asaj të Kosovës në veçanti, dua ti uroj me gjithë zemër:

GËZUAR I DASHUR JOE!

NJOHJA ME JOSEPH DIOGUARDIN, PRESIDENT I LQSHA-SË, NË STAMBOLL

Në mesin e viteve '90, kur dukej se demokracia në Shqipëri po ecte mirë, gjendja në Kosovë po përkeqësohej çdo ditë e më shumë. Lufta në Bosnjë po bënte kërdrinë, ndërsa bota ende rrinte duarkryq. Ajo që u lejua të ndodhte në Bosnjë, sidomos me masakrën e Srebrenicës, e bëri njerëzimin të rrënqethej, por edhe të turpërohej.

Një ndër njerëzit që punonte më shumë për ta parandaluar një tragjedi të ngjashme si ajo edhe në Kosovë, ishte Joseph DioGuardi. Ishte kjo arsyeja përse ne, si Konsullatë e Republikës së Shqipërisë në Stamboll, u angazhuam me çdo mjet për ta pritur atë në Turqi. Ai do të fliste me autoritetin që kishte, si ish-kongresmen amerikan, rreth situatës në Kosovë dhe çfarë mund të bëhej për parandalimin e një tragjedie si ajo e Bosnjës.



DioGuardi dhe Shirley Cloyes në Stamboll, 1995

Udhëtimin e parë e bëri në marsin e vitit 1994, ku mori pjesë në një Konferencë Ballkanike në Stamboll, e cila u sponsorizua nga Fondacioni i Solidaritetit Ballkanik.

Në atë konferencë, pa asnjë lloj ngurrimi apo kompleksi, DioGuardi dënoi ashpër veprimet e Sllobodan Milosheviçit si dhe qëndrimet e Lordit Owen dhe Carrington, Departamentin e Shtetit Amerikan, Tuxhmanin, Gligorovin, si dhe qeverinë greke. Mund të thuhet se ai ishte zëri më i fuqishëm i asaj konference. Duke marrë shkas nga ajo që po ndodhte në Bosnjë, ai u ndal te keqtrajtimi i shqiptarëve dhe rreziqet që mbarte transferimi i konfliktit prej Bosnjës në Kosovë. Nuk vonoi dhe në shtatorin e vitit 1995, ai e vizitoi përsëri Stambollin, po për të njëjtën arsye.

Ai mori pjesë bashkë me Shirley Cloyes - DioGuardi, Këshilltare e Çështjeve Ballkanike, në një konferencë në Qendrën e Shtypit të Universitetit Marmara në Stamboll, ku erdhën edhe shumë diplomatë, akademikë, studiues të çështjeve ndërkombëtare, si dhe personeli i fakultetit të marrëdhënieve me jashtë të universitetit. Konsullata Shqiptare ishte e pranishme dhe ndihmoi në organizmin e aktivitetit.

Në atë kohë ne nuk shpërfillnim asnjë mundësi që na jepej për të folur dhe vepruar për Kosovën. Vizita e DioGuardit pati shumë efekt në njohjen e disa qëndrimeve ndaj

Kosovës, që vinin nga miq dhe dashamirës të shqiptarëve, por edhe të çedimit të institucioneve ndërkombëtare dhe të dërguarve të posaçëm, ndaj të cilëve ai fliste hapur dhe pa rezervë.

Ajo që vura re tek ai, në vitet e bashkëpunimit të afërt me të, ishte kërkesa për arritjen maksimale të synimeve të kombit shqiptar dhe moslënia shteg e interpretimeve rreth të drejtave të shqiptarëve në Ballkan. Konsullata bashkëpunoi me Shoqatën “Vëllezëria Turko - Shqiptare”, e cila financoi udhëtimin e Joseph DioGuardit dhe Këshilltares për Çështjet Ballkanike, zonjës Shirley Cloyes - DioGuardi.

ME LIGËN QYTETARE SHQIPTARO - AMERIKANE NË MBROJTJE TË ÇËSHTJES SË KOSOVËS



“Maksimalistët” e Çështjes Kombëtare Shqiptare: Zërat më të fuqishëm, Joseph dhe Shirley Cloyes - DioGuardi, të cilët nuk pranojnë asgjë më pak se një Shqipëri brenda kufijve të saj etnikë në Ballkan.

Në historinë bashkëkohore të shqiptarëve, njëri ndër njerëzit që ka kontribuar më shumë në çështjen tonë kombëtare është amerikanin me origjinë arbëreshe, Joseph DioGuardi. Veprimtaria e tij në shërbim të çështjes kombëtare shqiptare është shumë e njohur. Vlen të përmendet më së pari se ai ka shërbyer si anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve, nga Partia Republikane, nga viti 1985 deri në vitin 1989. Pasi u largua nga

Kongresi dhe ishte njohur me situatën e shqiptarëve në Ballkan, përfshirë diktaturën komuniste në Shqipëri dhe përndjekjen e vazhdueshme ndaj shqiptarëve në ish-Jugosllavi, ai ndërmori veprime historike për të cilat ne shqiptarët duhet t'i jemi përherë mirënjohës: Ngritjen e çështjes së Kosovës në SHBA dhe në botë, si dhe ndihmesën ndaj proceseve demokratike në Shqipëri.

Ai bëri miq, të cilët ndikuan në mënyrë të jashtëzakonëshme në zhvillimet demokratike në Shqipëri dhe në njohjen e çështjes së Kosovës, veçanërisht në Washington. Në të njëjtën kohë arriti që, në qarqet e rëndësishme lobiste në SHBA të bëjë të njohur një histori fisnike të fshehur për pesëdhjetë vjet: atë të mbrojtjes së hebrenjve nga shqiptarët gjatë periudhës së Hollokaustit.

Me krijimin e Ligës Qytetare Shqiptaro - Amerikane, ai doli si lobist shumë i fuqishëm dhe efektiv, njësoj siç ishte "Vatra" më parë, e cila i doli zot Shqipërisë me parullën noliane:

"Mbahu nëno, mos ki frikë, se ke djemtë në Amerikë!"

Kjo ishte (dhe mbeti edhe më tej) motoja, që i nxiti shqiptarët e Amerikës ta ndihmonin atë me të gjitha forcat dhe mundësitë e tyre, më së shumti financiare, por edhe me njohjet e tyre në zonat zgjedhore, ku jetonin. Në nëntor të vitit 1989, DioGuardi shfaqet në Qendrën Ndërkombëtare të Shtypit në Beograd dhe dërgon në zyrën e Milosheviçit një letër të nënshkruar prej Senatorit Robert Dole dhe 12 senatorëve të tjerë amerikanë, për lirinë e Kosovës.

Që andej ai udhëtoi për herë të parë në Kosovë dhe aty mbajti fjalimin e tij historik përpara Hotelit "Grand" kundër Slobodan Milosheviçit. Më pas e vizitoi Jugosllavinë edhe dy herë të tjera, deri sa iu ndalua hyrja nga regjimi i diktatorit serb. Po ashtu, udhëtoi në Shqipëri, bashkë me Kongresmenin Tom Lantosh, më 30 Maj 1990, ku panë me sytë e tyre "fosilet" që po linte pas komunizmi, i cili ishte në grahmat e fundit.

BASHKËPUNIMI ME DIOGUARDIN PËR ÇËSHTJEN E KOSOVËS

Vetëm pak kohë pas ardhjes së tyre në Stamboll, në vitin 1995 udhëtova për Amerikë dhe vizitova Ligën Qytetare Shqiptaro - Amerikane, në Ossining, New York. Por lidhjen më të madhe me Join, siç e thërrasim ne, e pata në vitin 1998. Në atë kohë u vendosa përkohësisht në New Jersey. Menjëherë i ofrova shërbimin tim ndaj çështjes së Kosovës, LQSHA-së të drejtuar prej tij. Punuam rreth dy vjet pa pushim. Nga zyra e tij e thjeshtë amerikane në Ossining kemi bërë shumë gjëra të rëndësishme për Kosovën.



Përpara Capitol Hill, në një marshim për çlirimin e Kosovës me drejtorin e VOA (Zëri i Amerikës), Dr. Elez Biberaj - Mars 1995.

PAK HISTORI RRETH QYTEZËS SË VOGËL AMERIKANE OSSINING NË NEW YORK

Ossining-u është një qytezë me histori të re, e banuar ndoshta nga jo më shumë se njëzet mijë banorë. Ajo dikur banohej prej vendasve indianë, të njohur si Sint Sinck, të cilëve iu mor toka në vitin 1685. Pas shumë vitesh të luftërave dhe përpjekjeve ajo zonë, e cila shtrihet paralel me Lumin Hudson, ishte konfiskuar plotësisht në vitin 1779. Qyteza gjendet në anën lindore të lumit, rreth njëzet kilometra në veri të Urës Topenzi, që lidh shtetin e New Yorkut me atë të New Jersey-it. Në qendër të qytezës shtrihen disa objekte si Kisha e Kalvarit Baptist, ish-fabrika e Benjamin Breandith-it e shekullit të nëntëmbëdhjetë etj.

Ajo qytezë do të ishte krejt e thjeshtë dhe ndoshta pa ndonjë rëndësi për ne shqiptarët, nëse aty nuk do t'i kishte zyrat Lidhja Qytetare Shqiptaro - Amerikane, e themeluar dhe e drejtuar prej Joseph DioGuardit. Në atë zyrë të vogël periferike të New Yorkut janë shkruar shumë dokumente, të cilat kanë pasur rëndësi shumë të madhe

historike dhe ndikim të madh në fatin e demokracisë në Shqipëri e në Kosovë. Aty shkruheshin Rezoluta Kongresi, fjalime me vlerë, organizoheshin takime me kongresmenë e senatorë, politikanë e studiues, analistë politikë dhe miq të popullit shqiptar.

Kur shkova aty, në verën e vitit 1998, gjendja në Kosovë po arrinte pikën kritike. Bashkësia ndërkombëtare ishte në një gjendje të paqartë se çfarë do të bënte me këtë çështje, e cila po merrte përmasat e një tragjedie mu në zemër të Evropës, e që po kthehej në një turp për njerëzimin modern. Nga ajo zyrë bëheshin telefonata, niseshin letra e mesazhe drejt administratës amerikane të Presidentit Clinton, Kongresit dhe Senatit Amerikan, si dhe kancelarive evropiane. Që aty i bëhej thirrje ndërgjegjes së njerëzimit për ta ndërprerë një proces shfarosjeje dhe genocidi ndaj popullit shqiptar të Kosovës.

DioGuardi dhe këshilltarja e tij, publicistja e njohur Shirley Cloyes, nuk pushonin as edhe një minutë së përpjekuri për Çështjen e Kosovës. Në mbështetje të tyre ishin vënë një numër i madh shqiptaro - amerikanësh, të cilët nuk kursenin gjë për ta ndihmuar atë, në çdo mënyrë, e veçanërisht me financa. Liga funksiononte si institucion i përsosur me fondet që mblidhnin nga shqiptarët dhe Joi, po ashtu, nuk pushonte duke udhëtuar nga New York-u në Washington D.C, sa në Kongres e në Senat e sa në Turqi e në Evropë. Ai ishte në ato kohëra aktivisti dhe lobisti më i fuqishëm, që i dha zë çështjes sonë kombëtare. Shumë shqiptarë në atë periudhë mblidhnin fonde vetëm e vetëm që "makina" e DioGuardit të funksiononte. Takimet me vendim-marrësit ishin shumë të rëndësishme, sepse, siç thoshin amerikanët, "Ne po e krijojmë dosjen tonë të Kosovës", ndërsa ata vetë kishin nevojë të "edukoheshin", pra të mësonin rreth çështjes sonë.

Natyrisht që Liga nuk ishte e vetmja. Në anën tjetër Federata Pan-Shqiptare "Vatra", bënte edhe ajo të njëjtën gjë, si edhe plot shoqata të tjera shqiptaro - amerikane, shpeshherë të sapokrijuara dhe vetëm për atë periudhë. Liga organizonte shpesh udhëtime për Washington D.C. dhe ajo që e bënte edhe më interesante ishte se jetonte me ndihmesa të vogla të njerëzve të thjeshtë, të cilët, në shumë raste, për shkak të punëve të vështira që bënin, kontribuonin me çeqe, por nuk merrnin dot pjesë nëpër tubime, demonstrata dhe protesta.

Protestat ishin bërë të zakonshme dhe shpesh Capitol Hill mbushej me flamuj shqiptarë dhe amerikanë, me të cilët demonstroinin për orë të tëra, duke ftuar edhe anëtarë të Kongresit e Senatit, sidomos miq të DioGuardit, por edhe të shqiptarëve të tjerë. Ata dilnin nga seancat e tyre të punës dhe flisnin në favor të kauzës sonë. Pra, çdo shqiptar jepte ndihmesën e tij në një mënyrë ose një tjetër.

Ndihmesa ime e asaj kohe nuk mund të ishte financiare, për shkak të vështirësive të fillimit të jetës në Amerikë, por me ndihmën e djalit tim, Erionit, arrija të përballoja shpenzimet e udhëtimit deri në Ossining dhe e bëja "donacion" kohën time pesë ditë në javë, që i kushtoja asaj çështjeje. Kjo lloj ndihmese ishte e domosdoshme dhe mjaft e vlefshme. Zyra ishte 65 milje larg në vajtje dhe po aq në kthim, ndërkohë që duheshin kaluar disa ura dhe terminale me pagesë me një "Kadillak" të vogël që ma kishte dhuruar DioGuardi.

Asgjë tjetër nuk ishte më e rëndësishme se Kosova në atë kohë.

PUNA E PASHSEMBULLT E LIGËS QYTETARE SHQIPTARO - AMERIKANE

Ajo që pashë në atë kohë në punën që bënin këta njerëz për çështjen shqiptare është e pashembullt dhe e vështirë ta përshkruaj. Natë dhe ditë, pa pushim, në zyrë, në makinë, në restorant, në kafe, në ecje, ata ishin në kontakt me njerëz të rëndësishëm. Takuam shumë personalitete të shtetit amerikan të asaj kohe. Lidhjet e tyre shkonin shumë lart. Ndër ta mbaj mend takimet me senatorin Robert Dole, mik i madh i shqiptarëve, republikanin Henry Hyde, Kryetar i Komisionit të Marrëdhënieve me Jashtë i Kongresit Amerikan, kongresmenin Benjamin Gilman, i cili e mori më vonë po të njëjtën detyrë, Kongresmenin hebreo - amerikan Tom Lantosh, senatorin Porter, senatorin Nickles-D'Amato dhe i fundit, por jo më i parëndësishmi për kohën e vet, senatorin John McCain.

ME KONGRESMENIN BENJAMIN GILMAN PËR KOSOVËN



Me Kongresmenin Benjamin Gilman, Kryetar i Komisionit të Jashtëm të Kongresit Amerikan në një takim për Kosovën. Lart nga e majta në të djathtë: Mal Berisha, Hon. Ben Gilman, e shoqja Xhorxhia, Hon Joseph DioGuardi, e shoqja Shirley Cloyes -DioGuardi, gazetari Beqir Sina. Ulur: Ing. Zyhdi Karagjozi, Dr. Gjon Buçaj, z. Zef Përndocaj, z. Florim Xhema.

Ishin pikërisht ato ditë kur Çështja e Kosovës kishte arritur në pikën e vlimit. Takimet me kongresmenët dhe senatorët amerikanë qenë shtuar shumë. Një ndër takimet më të rëndësishme të asaj kohe ishte ai me Kongresmenin Benjamin Gilman. Ai ishte burrë i qetë, në një farë moshe (i lindur në vitin 1922). Ka shërbyer plot 30 vjet në Kongresin Amerikan, si republikan. Ai kishte miqësi të afërt me Joseph DioGuardin, miqësi që ishte forcuar shumë pas zbulimit nga ana e Joit, e historisë së hebrenjve në Shqipëri.

Ben Gilman-i ishte hebre dhe e kuptonte më mirë se shumëkush atë që kishte bërë populli shqiptar.

Në atë mbrëmje të shkurtit 1999 gjatë darkës, bashkëshortja e kongresmenit, Xhorxhia, e cila ishte me origjinë greke, na tha: "Ju mos u merakosni, sepse Beni do të bëjë gjithçka për ju shqiptarët. Mos u shqetësoni, sepse ju ndihmoj edhe unë".

Nga fjalët e saj kuptohej se çështja e Kosovës kishte marrë përmasa shumë të mëdha, dhe kishte bërë që të reflektonin edhe njerëz që nuk kishin ndonjë afinitet me çështjen shqiptare.

KONFERENCA E RAMBUJESË DHE KONTRIBUTI I JOSEPH DIOGUARDIT

Në fillim të vitit 1999 ndodhën ngjarje shumë të rëndësishme për Kosovën. Ndër to veçohen masakra e Reçakut dhe Konferenca e Rambujesë. Bashkësia ndërkombëtare u angazhua seriozisht për ta penguar një gjakderdhje të re në Ballkan. Në fakt, përvoja e Dayton – it, si marrëveshje paqeje për Bosnjën, kishte lënë shije shumë të keqe për shkak të defekteve të jashtëzakonshme që ajo mbarte. Për më tepër, shqiptarët as që ishin konsideruar në atë rast, ku vetëm Milosheviçi, Izetbegoviçi dhe Tuxhmani ishin palë, të ndërmjetësuar nga amerikanët.

Ajo marrëveshje që nënshkruar edhe nga Presidenti Amerikan Bill Clinton, Kryeministri Spanjoll, Filipe Gonzales, Presidenti i Francës Zhak Shirak, Kryeministri britanik John Major, Kancelari gjerman Helmut Kol dhe kryeministri rus Viktor Çernomyrdin. Ajo marrëveshje solli paqe, por asnjëherë stabilitet në Bosnjë e Hercegovinë. Por çfarë dukej se do të sillte konferenca tjetër ndërkombëtare, e cila kishte si qëllim po të njëjtën gjë - të sillte paqe në Ballkan e veçanërisht në Kosovën që ishte në prag të një shpërthimi të tmerrshëm?

MARRËVESHJA E RAMBUJESË - MË E KEQJA E NËNSHKRUAR NGA SHQIPTARËT DHE E KUNDËRSHTUAR NGA DIOGUARDI

Drafti i Marrëveshjes së Rambujesë, i cili u negociua midis shqiptarëve dhe serbëve me ndihmën e amerikanëve dhe veçanërisht dy diplomatëve, Richard Hollbrook dhe Christopher Hill, me gjithë dashamirësinë e tyre, nuk ishte gjë tjetër veçse më pak sesa një lëshim shumë i madh i bashkësisë ndërkombëtare ndaj Milosheviçit.

Dokumenti final linte në fuqi administrimin serb mbi Kosovë, me autonomi diçka si ajo që kishte pasur, pak më e zgjeruar se në kohën e Jugosllavisë titiste, që ishte marrë brutalisht nga Milosheviçi në vitin 1989. Joseph DioGuardi, si edhe politikanët më atdhetarë shqiptarë, që në atë kohë ishin në opozitë, e kundërshtuan me forcë këtë marrëveshje. Ai doli në ballë të përpjekjeve për ta redaktuar projektin dhe e kundërshtoi atë me forcën më të madhe. Si politikan profesionist amerikan, ai e kuptonte më mirë se çdokush tjetër se për Amerikën dhe Fuqitë e Mëdha, stabiliteti ishte më i rëndësishëm sesa realizimi i të drejtave të shqiptarëve. Kjo është arsyeja përse diplomatë si Hill dhe të tjerë iu imponuan shqiptarëve, të cilët nuk kishin ndonjë mbështetje tjetër, përveç asaj amerikane, dhe sado e pamjaftueshme që ishte ajo në atë moment, sigurisht që nuk mund ta refuzonin. Në një takim të shumë aktivistëve të LQSHA-së, Joseph DioGuardi deklaroi:

“Marrëveshja e Rambujesë është e para marrëveshje në historinë e shqiptarëve, nëpërmjet së cilës kanë nënshkruar me dorën e tyre të drejtën serbe mbi Kosovën dhe për rrjedhojë skllavërimin e mëtejshëm nën sovranitetin serb mbi Kosovën”.

Me atë rast Liga vendosi që Joi dhe Shirley të udhëtonin urgjent për në Paris. I përcolla atë natë në Aeroportin “Liberty” në Newark të New Jersey-it. Ai ngiste një makinë “Kadillak” të thjeshtë. Në vend të parë ishte ulur Shirley. Vendimi për të udhëtuar ishte marrë menjëherë. Me shpejtësi ata u bënë gati, morën dosjet, hipëm në veturë dhe DioGuardi e mori vetë timonin. Në anën e djathtë ai kishte një telefon satelitor që komunikonte pa ndërprerje me miqtë e tij në Washington, New York dhe Evropë. Nga ngutja dhe shpërqëndrimi në telefon bëri një dalje të gabuar nga autobandi Turnpike South për në autobandën 78 West, drejt perëndimit. Ishte dalje në drejtim krejt të kundërt me aeroportin, e cila iu shkaktoi humbje kohe prej më shumë se gjysmë ore deri sa gjeti një dalje tjetër për kthim mbrapsht. Paguam dy herë terminalet dhe u kthyem në drejtimin e duhur. Klithmat e Joit ndiheshin deri në qiell:

“Si ka mundësi, tre njerëz intelgjentë humbasin rrugën?!” ...

Arritëm në terminal në momentin e fundit. Të nesërmen ata u shfaqën përpara Kështjellës së Rambujesë. Në atë kohë shumëkush e ka kundërshtuar qëndrimin e DioGuardit, por nëse lexohet edhe sot me pak vëmendje dokumenti përfundimtar i Marrëveshjes së Rambujesë, ai e lë Kosovën në statusin e autonomisë. DioGuardi ishte kundër. Ajo që ndodhi më pas është ajo që anglezët e quajnë “*by default*”.

Ndodhi mrekullia që kryeministri serb, Milutinoviç nuk e nënshkroi marrëveshjen, por ua hodhi në fytyrë ndërkombëtarëve në çastin kur po linte kështjellën. Mungesa e një marrëveshjeje solli ndërhyrjen ushtarake të NATO-s të udhëhequra nga SHBA-ja. Konsideroj se roli i Joseph DioGuardit ka qenë dhe mbetet historik edhe në këtë moment të rëndësishëm për Kosovën. Nëse serbët e nënshkruanin marrëveshjen, Kosova mbetej me statusin e një autonomie nën pushtetin serb. Aty flitej për një autonomi me të drejtë referendumi pas tre vjetësh, por a do të arrihej dot kjo?

A ishin serbët tradhtarë të çështjes së tyre në Rambuje? A ishin serbët tradhtarë, që nuk e pranuan atë zgjidhje me konsekuenca minimale për ta, dhe asnjë përfitim për shqiptarët, kjo përbën një pikëpyetje të madhe. A ishin ata agjentë të shitur, apo naivë, këtë ende nuk e ka vlerësuar historia. E vërteta është që situata nuk mbante më, serbët nuk nënshkruan, shqiptarët pranuan një dokument, ndoshta me premtime të strukturave të fshehta, që do t’i bëjë të skuqen gjithë jetën.

Prapëseprapë, kokëfortësia serbe dhe “toleranca” shqiptare i shkuan për shtat zgjidhjes së çështjes së Kosovës, pra fillimit të luftës. Joseph DioGuardi ishte në anën e së drejtës, por a ishte edhe në anën e historisë? Kjo çështje han diskutim.



Gjatë një takimi në mjediset e Capitol Hill, Washington DC.

JOSEPH DIOGUARDI, "MAKSIMALIST" I NDERSHËM I ÇËSHTJES SHQIPTARE

Joseph DioGuardi është personi, i cili vepron me atë që bota e quan kërkesë maksimaliste shqiptare, por në të vërtetë ajo është kërkesa më e natyrshme: Bashkimi i kombit shqiptar në trojet e veta etnike në Ballkan. I vetmi aktivist i çështjes kombëtare, i cili nuk ka çeduar kurrë e që nuk ka bërë lëshime, ka qenë dhe mbetet Joseph DioGuardi. Thujse çdo politikan shqiptar i është trembur stigmës "*Shqipëria e Madhe*" e sajuar nga qarqet antishqiptare, veçanërisht ato sllave, e bashkë me ta, nganjëherë, edhe përfaqësues të aleatëve perëndimorë që e kanë me pikatore dashurinë për kombin shqiptar. Fjala e parë që çdo diplomat dhe politikan perëndimor të thotë është:

"A synoni ju shqiptarët të bashkoheni në një shtet të vetëm?", sikur ky është fundi i botës. Kjo në përgjithësi i ka kompleksuar politikanët shqiptarë, por jo Joseph DioGuardin.



Bordi i Ligës në mjediset e vendim - marrësve amerikanë në Washington DC

KONTRIBUTI I LQSHA-SË NËPËRMJET LIBRIT HISTORIK “SHPËTIMI NË SHQIPËRI” DHE NDIKIMI QË PATI AI TEK LOBI HEBRAIK NË SHBA

Në tetor të vitit 1997 Liga Qytetare inicioi botimin e librit “Shpëtimi në Shqipëri” (Rescue in Albania) me parathënien e dy kongresmenëve hebrej më të fuqishëm, Tom Lantosh dhe Benjamin Gilman. Roli i këtij libri ka qenë i jashtëzakonshëm dhe kontributi i DioGuardit në këtë drejtim është i pazëvendësueshëm. Librin e shkroi filantropisti hebre, Harvey Sarver. Liga shpërndau në gjuhën angleze plot 10 mijë ekzemplarë të këtij libri, i cili pati një efekt në ndërgjegjësimin e njerëzve më eminentë të SHBA-së, në njohjen e popullit shqiptar dhe qëndrimin e tij human të veçantë në një botë, ku mbretëronte krimi ndaj hebrevjeve prej nazistëve në të gjithë Evropën. Si anëtar aktiv i Ligës Qytetare, si edhe shumë të tjerë, kam shpërndarë qindra kopje të këtij libri te hebrevjtë e Amerikës anembanë dhe, më vonë, edhe tek ata të Anglisë.

Dua të kujtoj se në kohën e këtyre ngjarjeve që po u referohem, në drejtim të shtetit amerikan gjendeshin personalitete të tilla me origjinë hebreje si Samuel Richard, “Sandy” Berger, Këshilltari i Çështjeve të Sigurisë Kombëtare i Presidentit Clinton, Sekretari i Mbrojtjes William Cohen, Sekretarja e Shtetit Madeleine Albright, zv/Sekretari i Shtetit, James Rubin, Gjenerali i Shtabit të Ushtrisë, Wesley Clark si dhe kongresmenët më aktivë Tom Lantosh, Benjamin Gilman dhe senatori Chuck Shumer.

Roli i këtij libri është i jashtëzakonshëm, sepse ndihmoi që çështja e shfarosjes së shqiptarëve në Kosovë, të vihej në vijë paralele me atë të Hollokaustit kundër hebrevjeve.

DioGuardi më dha mundësinë ta përktheja librin në shqip, të cilën e shpërndamë në rreth dy mijë kopje edhe te shqiptarët, të cilët nuk e kishin idenë rreth kësaj historie kaq të mrekullueshme e fisnike, që kishin treguar në atë kohë ndaj hebrevjeve.

Puna ishte që asnjë hebre, i cili i di mirë vuajtjet e racës së tij, të mos mbetej pa mësuar se cilët ishin ata, që në ditët e tyre më të errëta, i mbrojtën edhe përkundër rrezikut që merrnin mbi vete.

NË KËSHILLIN E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË TË KONGRESIT AMERIKAN, NË CAPITOL HILL

Një ditë marsi të vitit 1999, një grup aktivistësh të Ligës, u nisëm për në Washington D.C, me shpresën dhe besimin se do të bënim aq sa të mundnim për të ndihmuar Kosovën që të gjente mbështetjen e duhur e të fitonte lirinë që meritonte.

Hymë në ndërtesën e Kongresit Amerikan. Në tribunën e sallës së Komisionit të Jashtëm erdhën dhe zunë vendet anëtarët e tij, të cilët do të dëgjonin mendimet *pro* dhe *kundër* të dy paneleve, me nga tre anëtarë. Atë e drejtonin kongresmenët Henry Hyde dhe Tom Lantosh.

Zhvillimi i kësaj seance dëgjimore doli të ishte vendimtare për fatin e Kosovës, pasi administrata mbështetej shumë në opinionin e saj. Kongresmeni Tom Lantosh, i cili

hapi seancën, shpalosi një panoramë të shkurtër, por të qartë e të plotë, mbi situatën në Kosovë dhe më pas, vazhdoi me debatin.



Me Senatorin Robert Dole, Ambasadorin Jeane Kirkpatrick dhe ish Sekretarin e Shtetit, Henry Kissinger

Paneli i parë dhe kryesor përbëhej nga senatori Robert Dole, mik i madh i shqiptarëve, ambasadorja Jene Fitzpatrick dhe ish Sekretari i Shtetit dhe diplomati më me përvojë në politikën e jashtme amerikane, Henry Kissinger.

SENATORI ROBERT DOLE NË SHKUP, PËR KOSOVËN

Senatori Robert Dole u ngrit dhe, duke mbajtur lapsin në dorën e tij protezë, përshkroi udhëtimin e tij njëjavor në Shkup. Ai foli për dëshmitë e shumta të barbarizmave serbe kundër shqiptarëve, që kishte mbledhur atje, për shpërnguljen masive të popullsisë, vrasjet dhe torturat jashtë syve të vëzhguesve të OSBE-së, ose siç quheshin në atë kohë, verifikatorëve. Ai u ndal te Milosheviçi dhe krimet e tij. U shpreh i pakënaqur me veprimet e H. Sh., të cilin kishte kërkuar ta takonte në Shkup, në pamundësi për të hyrë në Kosovë, por që i ishte thënë se ai ishte në front, në Drenicë. “Për habinë time”, - tha ai, “pashë në televizion se ai ishte duke mbajtur një konferencë në hollin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë”. Toni i tij ishte tmerrësisht kritik. Megjithatë e mbylli diskutimin, me thirrjen për ndërhyrje të ashpër ushtarake kundër Serbisë.

“Krimineli Milosheviç”, - tha ai, - “duhet goditur ashpër, pa mëshirë dhe kështu do të mbrohej një popull, i cili po shkonte drejt shfarosjes. Ai kupton vetëm një gjuhë: Atë të tankeve dhe bombave”.

AMBASADORJA JEANE KIRKPATRICK PËR KOSOVËN

Pas tij e mori fjalën Ambasadorja Jeane Kirkpatrick. Ajo mbajti të njëjtën linjë. Foli gjatë, qartë, kthjellët, e me shumë argumente për historinë e terrorit serb ndaj shqiptarëve dhe, se ata duhej të mbroheshin me çdo mjet dhe këtë mund ta bënte vetëm Amerika, bazuar në vlerat e saj demokratike, në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të kombeve të vegjël.

HENRY KISSINGER PËR JUGOSLLAVINË

Pas tyre do të fliste njeriu më me autoritet në fushën e diplomacisë, jo vetëm në SHBA, por edhe në të gjithë botën. Ai u ndal te ruajtja e sovranitetit të një shteti, përmendi rastet kur ndërhyhet ushtarakisht dhe pse nuk mund të ndërhyhej ndaj Serbisë dhe pse çështja mund dhe duhej zgjidhur vetëm me mjete diplomatike.

Ky ishte zëri ndryshe, por ishte zë shumë i fuqishëm, shumë i fortë dhe gati tronditës për të gjithë ne që ishim aty.

LQSHA DHE NAAC KUNDËR PËRFAQËSUESVE TË INSTITUTIT “CATE”

Pas kësaj fjalën e morën me radhë, Shirley Cloyes - DioGuardi, këshilltare për çështjet e Ballkanit pranë LQSHA, Ilir Zherka, President i NACC, (Këshilli Kombëtar Shqiptaro - Amerikan) dhe më pas edhe një përfaqësues i Institutit Cate, organizatë joqeveritare shumë e afërt me serbët.

Argumentet e dy të parëve ishin tërësisht në një linjë me ato të Senatorit Robert Dole dhe Ambasadores Kirkpatrick, ndërsa ato të përfaqësuesit të Institutit Cate përkonin me ato të Henry Kissinger-it.

AGIM ALIÇKAJ ME LIBRIN NË DORË, “SHPËTIMI NË SHQIPËRI”

Pas këtyre fjalimeve u bë një pushim i shkurtër. Bashkë me Agim Aliçkajn, aktivist i paepur i çështjes së Kosovës, iu afroam Henry Kissinger-it. Kishim me vete disa kopje të librit “Shpëtimi në Shqipëri” (Rescue in Albania), të cilat i shpërndanim kudo që mundeshim, sapo shihnim ndonjë hebre. Besonim shumë tek ai libër dhe historia që tregojë në të për mbrojtjen e hebregjeve nga shqiptarët gjatë gjithë historisë, por veçanërisht gjatë kohës së Hollokaustit.

Kështu në ato çaste sapo mbaroi seanca, Agim Aliçkaj iu afrua Henry Kissinger-it dhe u ul në gjunjë përpara tij. Ai ishte ulur në karrigen e tretë majtas të tavolinës së treshes kryesore. Agimi kishte në dorë një kopje të librit, ia tregoi dhe i tha:

“Zoti Kissinger, të lutem, merre këtë libër! Të lutem, merre dhe lexoje! Ju njiheni si poliglot, diplomat, filozof, historian e lexues dhe shkrimtari më i madh i politikës globale. Lexojeni dhe do të mësoni sesi një popull, që sot është për vete në prag të shfarosjes, i ka mbrojtur hebretë në kohët e tyre më të vështira, ani pse për vete ishte i pushtuar nga nazistët gjermanë”.

Agim Aliçkaj insistonte që Kissingeri ta lexonte atë libër dhe të mësonte se ishte po ai popull që po masakrohej sot nën Serbinë, ai populli që dikur ishte i vetmi, që mbrojtë njerëzit e tij - hebretë.

Kissingeri e mori librin në dorë, e shfletoi për një grimëherë, dhe i tha:

“Të siguroj që do ta lexoj me vëmendje”.

HENRY KISSINGER NË CNN INTERNATIONAL NATËN E 24 MARSIT 1999

Efkti i librit që iu dorëzua Henry Kissinger-it mund të ketë qenë i jashtëzakonshëm. Vetëm disa ditë më vonë, nga Mbledhja e Komisionit të Jashtëm të Kongresit Amerikan në Capitol Hill rreth çështjes së Kosovës, filluan bombardimet kundër caqeve ushtarake të Serbisë. E gjithë media botërore filloi menjëherë transmetimet e drejtpërdrejta nga baza ajrore italiane e NATO-s, Aviano, prej nga ngriheshin avionët, që bombardonin objektivat ushtarake serbe.

Natyrisht që *CNN International* ishte si përherë i pari që e njoftoi këtë. Ata ndërprejnë çdo lajm dhe e vonë kryelajmin në ekran.

Ishte lajmi i fundit:

I pari njeri, që i bekoi ato bombardime, ishte Henry Kissinger. Ai i tha CNN-it:

“Duhet shpëtuar populli shqiptar i Kosovës nga shfarosja, por edhe nderi i SHBA-së. Tani nuk ka kthim pas”, deklaroi Henry Kissinger, atë natë



Pas takimit në Capitol Hill, LQSHA del me shpresën e madhe se Amerika do e ndihmojë Kosovën.



Liga e Madhe e DioGuardit me miq të Mëdhenj si Benjamin Gilman.
Në dalje nga Capitol Hill me aktivistët e LQSHA-së.

Si përherë, Presidenti i Ligës e drejton grupin e mbështetësve të tij, Agim Aickaj, Luan Bukolla, Zef Balaj, Hafiz Shala, etj, nëpër labirinhet e Capitol Hill-it.

ERË LUFTE QË ERDHI DERI NË OSSINING - NEW YORK - USA

Mëngjesi i parë pas fillimit të bombardimeve të forcave ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë më gjeti në Ossining. Atë ditë, si edhe në ditët e mëparshme, isha ulur në tryezën e punës pranë asaj të DioGuardit.

Fillimi i bombardimeve kundër caqeve ushtarake serbe në ish-Jugosllavi kërkonte publicitet edhe brenda Amerikës, për ta mbajtur lart mbështetjen e opinionit publik ndaj administratës së Presidentit Clinton. Një nga zërat më të fuqishëm të asaj kohe në mediat amerikane u bë vetë DioGuardi me Shirley Cloyes.

Ata u shfaqën në atë kohë në rreth 50 kanale televizive e radiofonike përfshirë edhe CNN International, Fox-TV, BBC-TV, NBC, MSNBC, WPIX, dhe CNBC. Kjo vazhdoi gjatë gjithë kohës së luftës dhe disa kohë më pas.

Në atë kohë, i ngarkuar nga Joseph Dioguardi, pata rastin dhe nderin të paraqisja pikëpamjen shqiptare rreth asaj që po ndodhte në Kosovë nëpërmjet të televizionit CN8 Comcast Network, i cili transmetonte për pjesën lindore të SHBA-së. Po në atë kohë u angazhova në bazën ushtarake në Fort Dix ku rreth 6 mijë e 500 shqiptarë të Kosovës u katapultuan përmes ajrit nga Kampi i Bllacës dhe Stankovacit të Maqedonisë, për t'i mbrojtur nga lufta. DioGuardi bëri një vizitë historike në atë bazë. Takimi u bë në kishën e bazës ushtarake. Masa e kosovarëve të pranishëm, të cilët e dinin mirë ndihmesën e këtij njeriu shpërthente herë pas here në thirrje "USA - DioGuardi". Ai ishte një nga takimet më emocionale. Aty kishte njerëz, të cilët dikur e kishin pritur kongresmenin përpara Hotel "Grandit" në Prishtinë teksa sulmonte Milosheviçin, në vitin 1991, dhe tani në mes të Amerikës.

11 EMISIONE TELEVIZIVE NË CN8 COMCAST TELEVISION

Ishte pikërisht data e 25 mars 1999, një ditë pasi kishin filluar bombardimet e NATO-s kundër objektivave ushtarake të Sllobodan Milosheviçit, kur mora një telefonatë nga gazetarja e televizionit CN8 Comcast të shtetit të New Jersey-t, Liza Espagnola. Ishte menaxherja e personelit të gazetares së njohur amerikane Lyn Doyle. Ajo kërkonte të fliste me Joseph DioGuardin. Unë e mora në shënim numrin e saj të telefonit dhe i premtova se do ta njoftoja Join për kërkesën që kishte ai televizion, në mënyrë që të paraqitej aty për të shprehur, siç thoshte ajo - këndvështrimin shqiptar të konfliktit në ish-Jugosllavi. Menjëherë e njoftova Join dhe ai me atë furinë e veprimtarisë që e karakterizonte më tha:

"Shko ti! Duhet të shkosh ti! Na duhen njerëz që flasin, na duhen aktivistë, është kohë e vështirë, kohë lufte dhe secili le të bëjë të tijën! Shko ti, dhe na përfaqëso me dinjitet!"

E telefonova qendrën televizive CN8 Comcast dhe iu thashë se, në cilësinë e këshilltarit të Ligës, isha autorizuar të paraqitesha në atë debat televiziv. I dërgova rezymenë time dhe telefonata e tyre nuk vonoi. Me kërkuan të paraqitesha në qendrën televizive në qytetin Union, të shtetit të New Jersey-it, atë të enjte të 25 marsit 1999, në orën 20.00. Ishte hera e parë në jetën time që do të futesha në një debat televiziv, qoftë edhe në gjuhën shqipe.

Ossening, 24 Mars, 1999

NË STUDION TELEVIZIVE CN8 COMCAST ME GAZETAREN VETERANE LYN DOYLE

Kanali televiz CN8 Comcast transmeton për 110 milionë amerikanë që jetojnë në *East Coast* (Bregdeti Lindor). Emisioni titullohej *It's Your Call with Lynn Doyle* dhe organizohej me të ftuar ekspertë, analistë, politikanë e profesorë, të cilët flisnin për tema të rëndësishme të ditës. Emisioni kishte përherë një prelud me kronikë për ngjarjen e ditës dhe më pas të ftuarit jepnin opinionin e tyre. Fill më pas shpërthenin telefonatat për dhe kundër rreth temave që flisnin të ftuarit në studio. Ky emision ka fituar çmimin Emmy në Boston dhe New England shtatë herë rresht. Kështu filloi për mua emisioni *"It is your Call me Lyn Doyle"*.

Atë mbrëmje përballë kisha një profesor të Universitetit Rutger të New Jersey-it, i cili mbrojti me fanatizëm tezën e mosndërhyrjes së Shteteve të Bashkuara në konfliktin në Jugosllavi. Preludi i përgatitur nga televizioni tregonte ngritjen e avionëve nga baza ajrore e NATO-s në Aviano të Italisë dhe shpërthimet në bazat ushtarake serbe. Atë natë ishte planifikuar që emisioni të zgjaste një orë, por ndërhyrja e vazhdueshme e teleshikuesve dhe debati me argumente dhe kundërargumente bëri që të zgjaste një orë e gjysmë.

ME PROFESORIN E UNIVERSITETIT PRINCETON, WOLFGANG F. DANSPECKGRUBER

Të nesërmen studioja kërkoi që të vazhdonim këtë emision çdo të enjte, deri sa lufta të mbaronte. Dhe kështu në javën e dytë, u gjenda përpara një profesori të Universitetit Princeton. Ai ishte Wolfgang F. Danspeckgruber, drejtori themelues i Institutit Lihtenshtein për Vetëvendosje, në atq universitet. Ai jepte mësim për çështjet e teorisë së shtetit, të sigurisë ndërkombëtare, vetëvendosjes së popujve dhe diplomacisë si dhe për krizat diplomatike, në shkollën e Çështjeve Ndërkombëtare dhe Publike "Woodrow Wilson". Në fakt profili i tij shumë i lartë akademik i shkonte shumë mirë edhe argumentit për drejtësinë e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s, kundër Jugosllavisë.

Debati i dytë, ashtu si edhe i pari, shkoi mirë dhe zgjati bashkë me reklamat dhe ilustrimet nga Kosova një orë e gjysmë. Telefonat nuk pushonin dhe ndihej në masë shqetësimi i qytetarëve amerikanë për përfshirjen e Amerikës në këtë konflikt jashtë territorit të tyre. Pas emisionit, pimë kafe me profesorin, i cili të befasonte me gjerësinë e dijenive të tij gati të pafundme.

DEBAT ME SERBO - AMERIKANEN EDITA KRUNIÇ, PRESIDENTE E "UNIONIT TË SERBËVE TË AMERIKËS"



CN8 Comcast Television, New Jersey, USA Debat i drejtpërdrejtë për Kosovën në 11 emisione në studion e gazetares Lyn Doyle.

Në emisionin e tretë u gjenda përpara një të papriture. Kur hyra në hollin e studios, aty ku përherë na ofronin kafe dhe biskota, vura re një burrë me flokë shumë të gjata, të lidhura bisht kali dhe një zonjë të veshur me shije dhe e shëndetshme. Të dy ishin njerëz shumë të zymtë. Gazetarja Doyle nuk jepte ndonjë lloj orientimi mbi atë që do të flisnim, çfarë do të thotë se, ne mund të shpreheshim pa censurë.

Zonja përballë meje do të ishte Edita Kruniç, serbo - amerikane e lindur në Amerikë. Ndërsa burri, me flokët bisht kali ishte bashkëshorti, i cili, siç mësova më vonë, kishte ardhur pak kohë më parë nga Serbia dhe ishte gjithë mllef për atë, që po ndodhte përtej detit. Pas siglës së emisionit dhe preludit, pashë se në ekran u shkrua:

“Edita Kruniç, Presidente e Unionit të Serbëve të Amerikës.”

Në atë kohë në Amerikë shpërthyen si kërpudhat pas shiut lloj-lloj shoqatash e fondacionesh në mbrojtje të “kauzës serbe” të kombit të “sakrifikuar” dhe të “viktimizuar” ndër shekuj. Menjëherë kuptova se kisha të bëja me një drejtuese të një “krijese” të tillë. Debati u përqendrua, sipas saj, te persekutimi shekullor që serbët na paskëshin përjetuar në Kosovë prej shqiptarëve, në “djepin e Serbisë”, dhe në atë që mbrojta unë për të kundërtën dhe drejtësinë e ndërhyrjes së forcave të NATO-s. Pas emisionit të parë morëm përgëzime nga drejtuesja dhe u shpërndamë.

Kur arrita në shtëpi mora mjaft telefonata nga shumë shqiptaro - amerikanë, që e kishin ndjekur emisionin.

Tani kundërshtarë ishim Edita Kruniç dhe unë. Në një prej emisioneve doli në telefon një vajzë, e cila pretendonte se fliste nga Beogradi, por në të vërtetë dukej hapur nga aksenti i anglishtes së saj se ishte nga jugu i New Jersey-it. Ajo tha duke qarë:

“E kuptoni se çfarë do të thotë për një vajzë pesëmbëdhjetë vjeçare si unë, të mos guxojë të dalë mbrëmjeve nëpër rrugët e Beogradit që prej dy javësh, nga frika e bombardimeve të NATO-s?!”

Lyn Doyle e hapi debatin: Edita Kruniç e qau me lot “vuajtjen” e asaj vajze serbe për atë që po i ndodhte. Dhe pas kësaj gazetaria m’u drejtua mua:

“Po ju, çfarë komenti keni?”

I thashë se më vjen keq për vuajtjen e asaj vajze, por kur e di që me mijëra vajza shqiptare, moshatare të saj të Kosovës, flenë jashtë në borën dhe akullin e atyre ditëve nëpër male e pyje, të pangrëna dhe nën frikën e dhunës që ushtron një polici dhe ushtri, ku ndoshta edhe babai i asaj vajze është i mobilizuar, ngushëllohem për të. Madje, shtova, nga e folura më jep të kuptoj se ajo nuk flet nga Beogradi tani, kur atje është ora rreth tre e mëngjesit”.

Shpesh në linjë filluan të futeshin edhe shqiptaro - amerikanët. Një ndër to ishte Nurie Rugova, motra e fotografit të njohur, Fadil Berisha, e lindur në Kosovë, e cila me argumente dhe fakte mbështeti atë që mbroja edhe unë në atë studio. Ky debat zgjati dhjetë javë deri sa mbaroi lufta. Një emision u organizua në shtatorin e po atij viti, kuptohet pasi lufta kishte mbaruar. Kësaj radhe tema ishte për largimin e serbëve nga Kosova.

Këto njëmbëdhjetë emisione i kontribuan medias amerikane, e cila ishte angazhuar në mbajtjen lart të frymës pozitive të opinionit vendas për drejtësinë e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s kundër kriminelit Milosheviç dhe në mbrojtje të popullit shqiptar të Kosovës. Argumenti që jepnim ne shqiptarët në Amerikë ishte ndihmesë e madhe për mbajtjen lart të mbështetjes popullore demokratike ndaj aksionit ushtarak të drejtuar nga SHBA-Të.

Mars - prill - maj - qershor - shtator, 1999

NJË DITË ME SENATORIN JOHN MCCAIN PËR NJOHJEN E KOSOVËS SË PAVARUR, NË MANHATTAN

Me Ligën Qytetare Shqiptaro - Amerikane duke pritur Senatorin John McCain

Në fillim të vitit 2000, Kosova ishte vënë nën administrimin e UNMIK-ut, ndërsa shqiptarët art luftonin me çdo mjet që të arrinin shpalljen e pavarësisë së Republikës dhe njohjen e saj nga ana e Shteteve të Bashkuara. Për këtë veprimtari ishte përfshirë edhe Liga Qytetare Shqiptaro - Amerikane. Bashkë me veprimtarë të dalluar të Ligës si Agim Aliçkaj, Zef Bala, Vincent dhe Peter Saljani, David Balaj, Hazir Shala, Arslan Cekaj dhe një grup tjetër veprimtarësh dolëm në krye të një turme disamijëshe.

Përpara Hotel "Regent" kishim ngritur një podium dhe ishte vendosur një mikrofon prej nga mbaheshin fjalime dhe manifestohej me flamuj kombëtarë dhe me parulla për njohjen e pavarësisë. Pas rreth një ore, në rrugën 42, përpara Stacionit Qendror të Trenit u shfaq autobusi me parullën e fushatës së senatorit në ballë: "Straight Talk".

SENATORI JOHN MCCAIN ME STRAIGHT TALK (TË FLASIM PA DOREZA)

Senatori McCain, flokëbardhë i tëri, ekspresiv, me ecje të drejtë e krenare, doli nga autobusi dhe iu drejtua miniskenës që kishim ngritur. Ai hipi në podium dhe priti sa ta paraqiste DioGuardi, i cili tha ndër të tjera:

"Këtu është sot me ne një hero, një burrë që e njeh më mirë se kushdo sigurinë tonë kombëtare, pasi i ka kushtuar jetën shërbimit nën armë dhe po ashtu në Kongresin Amerikan".

Pastaj fjalën e mori senatori, ndërsa turma thërriste: "McCain President, McCain President". Ai foli për shqiptarët, foli për mbrojtjen që u kanë bërë hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe premtoi që, nëse bëhej President i Amerikës, ai do ta kishte çdo ditë në vëmendje çështjen e Kosovës deri në pavarësimin dhe njohjen e saj. Këtu ai e mbylli fjalimin dhe la pas një masë njerëzish të ngazëllyer nga premtimet e këtij burri të madh të kombit amerikan.

Pas kësaj, ai iu drejtua sallës tremijëvendëshe të Hotelit "Regent", ku do të mbante takimin zgjedhor të radhës. Ndërsa DioGuardi na e bëri me shenjë:

"Le të shkojmë edhe ne."

Zbrita nga tribuna dhe iu drejtova shkallareve të hotelit. Kur arrita në katin e parë, aty prisnin stjuartë, të cilët të orientonin drejt sallës ku bëhej takimi i senatorit me kontribuesit e vet. Eca nëpër një korridor të gjatë dhe përpara meje u shfaq një tavolinë, në të cilin ishin ndoshta pesëmbëdhjetë djem e vajza të reja, të cilët mblidhnin fonde për kandidatin. Në ballë të tavolinës shkruhej:

"McCain President! Kontribuoni për Presidentin tonë! Pranojmë çeqe, urdhër pagesa, karta krediti, por jo para në dorë! Minimumi i pranueshëm 250 dollarë, maksimumi 2.000 dollarë".

Kur pashë se hyrja aty bëhej me para, nxora nga xhepi një çek, vura shumën minimale, e nënshkrova dhe e dorëzova në tryezë. Eca drejt sallës, vajta dhe u ula ku gjeta një karrige dhe po dëgjoja senatorin ndërsa fliste. Në krahun e djathtë ai kishte bashkëshorten Cindy McCain, dikur Miss Arizona, ndërsa në të majtë kishte të bijën, me gruan e parë, po ashtu Cindy McCain. Ai e filloi fjalimin me një kompliment për të dyja dhe u betua se të dyja paguajnë taksa për çdo dollar që fitojnë. Për amerikanët të paguash ose jo taksa është jo vetëm detyrim ligjor, por edhe çështje nderi.

NJË KARTOLINË NGA SENATORI MCCAIN

Dola nga ai takim, kalova nga banka, depozitova diçka që çeku i lëshuar të ishte i mbuluar dhe shkova në shtëpi. Nuk kaloi as një javë dhe në adresën time të shtëpisë erdhi një zarf nga zyra e senatorit me emblemën "Straight Talk". E hapa dhe e lexova. Ishte një

kartolinë falënderimi për donacionin. Brenda kishte një foto shumë të bukur të senatorit me bashkëshorten Cindy-in dhe një mbishkrim:

“I dashur Mal, shumë falemnderit për mbështetjen tuaj, John & Cindy”.



Një kartolinë nga ish-pretendenti për nominim si kandidat Republikan për President i ShBA-së, Senatori John McCain Viti 2000.

HERO I MADH, EDHE PSE JO PRESIDENT

John McCain nuk mundi të zgjidhet President i Amerikës, por një takim me të mbetej në kujtesën e njeriut, ndërsa Amerika e nderoi atë përherë si heroin e vet, të burgosurin peng të Luftës në Vietnam që u bë kongresmen, senator, kandidat për President dhe më e rëndësishmja për ne: Një mik shumë i çmuar i shqiptarëve. Ai përherë e ka mbështetur Kosovën, madje në vitin 2009 zonja e tij Cindy e vizitoi atë, duke ngjallur diskutime të shumta në Serbi.

TAKIM ME GJENERALIN WESLEY CLARK



Foto me Gjeneralin Wesley Clark, mik i Ligës Qytetare Shqiptaro - Amerikane, pas botimit të librit “Waging Modern War”.

Në maj të vitit 2001, Gjenerali amerikan Wesley Clark, komandanti i forcave ushtarake të NATO-s botoi librin e tij “Të bësh Luftë Moderne”. Vetëm disa javë më vonë, në korrik, Liga Qytetare Shqiptaro - Amerikane organizoi një veprimtari me autorin. Pjesëmarrësit morën libra me autograf prej Gjeneralit, ndërsa Presidenti i Ligës, DioGuardi, i dha atij Mirënjohjen e Parë të Paqës në Ballkan, dekoratë e Ligës për personalitete të larta.

Në atë takim, Gjenerali Clark tregoi përvojën e tij në drejtimin e forcave të NATO-s në zhvillimin e Luftës Moderne drejt një fitoreje të suksesshme në Kosovë, në vitin 1999.

Ai tha se tanimë është bërë e qartë se mësimet që nxorëm nga lufta në Kosovë janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në luftën kundër terrorizmit dhe vendeve që e sponsorizojnë atë. Rasti i Kosovës na mësoi sesi të zhvillohet një luftë ajrore kundër forcave jokonvencionale në një terren të ashpër dhe si të bashkërendohen forcat ushtarake të Amerikës me ato të kombeve të tjera. Aq më shumë tha ai, ajo luftë na mësoi si të përballemi me armikun, që gjithnjë e më shumë kërcënon botën e sotme dhe vetë Amerikën. Gazeta “Los Angelis Times” ka shkruar për këtë libër:

“Mësimet e këtij libri janë shumë të rëndësishme tani ... Ne duhet të mendojmë saktësisht se cilët hapa do ta zvogëlojnë, në vend që ta rritin kërcënimin terrorist. Po ashtu ne kemi nevojë për komandantë të zotë, inovativë, të gatshëm, të improvizojnë në momentet e duhura për të përmbushur çdo detyrë në rastet më të vështira. Po ashtu koha kërkon udhëheqje politike të aftë dhe komandantë të zotë që kanë këndvështrim më fleksibël në Pentagon. Ky ishte Gjenerali Clark, i cili kreu me nder edhe një shërbim tjetër ndaj njerëzimit, me fitoren e kësaj lufte në një moment vendimtar për historinë Amerikane” ...

Ajo ishte një mbrëmje e paharrueshme. Takimi me një njeri që kishte komanduar bombardimet e 78 ditëve kundër objektivave ushtarake të Serbisë, të bënte të ndiheshë

sikur ishte përpara një fetishi, por që ai e thjeshtonte atë ndjenjë deri në nivelin njerëzor të komunikimit. Atë takim e fiksoi me aparatën e tij, si shumë e shumë ngjarje të tjera të tilla, gazetari i mirënjohur i bashkësisë shqiptare në New York, Beqir Sina.



PËRMBYLLJE

Historia e më e re e shqiptarëve – vetë çlirimi i Kosovës nuk mund të mendohet kurrë pa kontributin e arbëreshit – amerikan, Joseph DioGuardi dhe Ligës së Tij Qytetare Shqiptaro Amerikane.

Mal Berisha

Nderime per arbërorët tanë